

Dymujore
Dukative-arsimore
Përvise

ETIKA

Dymujore

Buka dhe falenderimi

Pasuria e vërtetë


Zoti ua shpërbleftë!

Risku apo furnizimi hyjnor

Elementet e demokracisë në islam

Shfrytëzoje kohën për të mësuar fenë tënde

Relikte Historike



*Të jesh i kënaqur
me çfarë je dhe çfarë ke*



EDITORIAL

I dashur lexues! Tema e radhës e revistës sonë është zemra e ngopur dhe e kënaqur e njeriut me atë që ai është në jetë dhe ato që i janë dhuruar prej Zotit si fizikisht edhe materialisht. Një çësh-tje e rëndësishme që duhet njohur lidhur me furnizimin e njeriut është edhe dallimi apo diferencimi mes njerëzve në ndarjen e kë-tij furnizimi. Padyshim që më shumë se një dallim ky diferencim bëhet për të caktuar rregullin dhe drejtësinë mes njerëzve.

Në Kur'an është përcaktuar qartë se thesari i çdo gjëje i përket Allahut dhe se çdo gjë bëhet në bazë të një programi të caktuar me të dhëna hyjnore. Besimtarët duhet të besojnë se këto situa-ta të ndryshme materiale janë në të mirën e tyre. Sikur rregulli i kësaj jete të kishte mbetur në dorë të vullnetit të pafuqishëm të njerëzve, në mbarë gjithësinë nuk do të ishte vënë re gjë tjetër veç anarkisë për shkak të dëshirave të njerëzv që nuk përpushten me njëra-tjetrën dhe të punëve që ndryshojnë çdo moment.


Ndarja e këtij rrisku apo furnizimi, e kompletuar me të fshehta, urtësi dhe forca të mbinatyrrshme është një nga treguesit e fuqisë më madhore. Në çdo moment përgatiten sofa-të ndryshme për të gjitha krijesat, qofshin ato që fluturojnë në ajër, qofshin ato që ecin në tokë apo edhe ato që notojnë në det. As njëri dhe as tjetri nuk mund të vazhdojnë deri në përfjetësi. Pra ushqimet e këtyre krije-save janë të ndara dhe të përcaktuara sipas vendit ku ndo-dhen dhe fakti që kemi një ndarje të këtij furnizimi të gjallesave të panumërtë të gjithësisë është një tregues i madh i urtësisë, fuqisë dhe salltanitet hyjnor në këtë gjithësi për të gjithë ata që mendojnë dhe gjykojnë.

Nisur nga kjo e vërtetë i dërguari i Allahut Muhamedi (a.s.) ka thënë:

"Kur ndonjëri prej jush të shohë atë që është mbi të nga ana financiare dhe fizike, ta kthejë vështrimin e tij edhe tek ai që është poshtë tij. Një gjë e tillë ndihmon që mos të nën-vlerësohet mirësia që jep Allahu." (Buhari, Rikak, 30; Muslim, Zuhd, 8; Tirmidhi, Kijamat, 59)

Prandaj ne jetojmë të qetë për sa kohë që besojmë se kjo ndarje e furnizimit të Zotit është në dobinë tonë. Ka shumë ngjarje që mund të shihen si një shkatërrim apo humbje për ne dhe në përfundim dalin një dhunti, si psh varfëria prapa së cilës qëndron xheneti. Por ka edhe situata të tilla që shfaqen si dhunti, por përfundimi i tyre është një humbje e dhembshur si psh: pasuritë që nuk jepen sadaka, por që mbahen vetëm për plotësimin e nevoja-ve vetjake. Në Kur'an thuhet:

"Hani nga të mirat që u dhuruam, e mos u bëni përbuzës se do t'u godasë hidhërimi Im, e atë që e zë hidhërimi Im, ai ka mbaruar." (Taha, 81)





www.progresibotime.com

NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI:

8



12



22



BUKA DHE FALENDERIMI

HASAN KAMIL JËLLMAZ

4

PASURIA E VËRTETË

ISMAIL LUTFI ÇAKAN

8

AGJËRIMI DHE DEVOTSHMËRIA

NAIM DRIJAJ

10

ZOTI UA SHPËRBLEFTË!

EVANS DRISHTI

12

DOMETHËNIA BESIMORE E PËRSHËNDETJES ISLAME

“ES-SELAMU ALEJKUM”

ORHAN BISLIMAJ

16

FELAJMËSIA (NUBUVETU)

DHE FEDËRGUESHMËRIA (RISALETU)

NË DRITËN E LIBRIT TË ALLAHUT

NEXHAT IBRAHIMI

22

KËSHILLA IME PËR ÇDO MUSLIMAN DHE MUSLIMANE

SHEJKH REXHEB DIB

26

TË JESH I KËNAQUR ME ÇFARË JE DHE ÇFARË KE

ANDËRSÖN MARKU

28

Korrik - Gusht 2009

AJETE DHE HADITHE	
30	
RRISKU APO FURNIZIMI HYJNOR	
<i>OSMAN NURI TOPBASH</i>	
32	
ELEMENTET E DEMOKRACISË NË ISLAM	
<i>RRUSTEM SPAHIU</i>	
40	
MARRËDHËNIET INTERRELIGJIOZE NË SHOQËRINË	
MULTIRELIGJIOZE	
<i>IVAN CVITKOVIQ</i>	
44	
SHFRYTËZOJE KOHËN PËR TË MËSUAR FENË TËNDE	
<i>ZYMER RAMADANI</i>	
50	
TEKNOLOGJI	
53	
RELIKTE HISTORIKE	
<i>ERMAL NURJA</i>	
54	
SHËNDETI DHE FAMILJA	
<i>ALI F. ILJAZI</i>	
56	
AKTUALITET	
58	

32



44



50



Viti: III Numri: 19

- Korrik - Gusht 2009
 - Rexhep - Shaban 1430

Boton

- Progresi sh.p.k.
 - Shkodër / Shqipëri

Përkthyes

- Arjan Ymeri
 - Ermal Nurja
 - Evans Drishti
 - Fatmir Sulaj
 - Ilir Hoxha
 - Ilir Rruga

Redaktor

- Islam Dizdari

Dizenjo - Grafik

- Bledar Xama
bledar_xama@hotmail.com

Ngjyra

- Progresi

Adresa

- L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi
 - Shkodër
 - Tel: +355 22 254 534
 - Fax: +355 22 254 533
 - Cel: +355 20 76768 / +355 20 86767

Shtyp

- ArbëriaDesign, Tetovë
 - Tel: +389 44 35 33 71
 - Fax: +389 44 35 33 72

Për artikuj

- e-mail: revistaetika@progresibotime.com
 - e-mail: kosova@progresibotime.com

Cmimi

- 1 Euro
 - 150 Lek
 - 60 DEN





Buka dhe Falenderimi

*S*i domosdoshmëri e ligjeve në këtë botë, njeriu është i detyruar të ushqehet që të vazhdojë jetën dhe qenien e tij. Edhe nëse ndryshon cilësia e ushqimit sipas statusit social apo gjendjes ekonomike të njeriut, ushqimi themelor në kulturat njerëzore është “**buka**”. Ndoshta në mënyrën e të ushqyerit ka lëndë më të nevojshme bazë, por **buka** është pranuar si lënda e parë që të ngop. Njeriu në të shumtën e rasteve në vend të shprehjes “të hamë ushqim” preferojnë të thonë “të

hamë bukë”. Njeriu e ka pranuar bukën si një mirësi dhe dhunti hyjnore, madje edhe grimcat e bukës të rëna në tokë nuk pëlqen t’i shkelë me këmbë duke e quajtur këtë një mungesë respekti ndaj kësaj mirësie. Buka është me të vërtetë një mirësi dhe dhunti shumë e madhe. Edhe punët dhe përpjekjet e bëra pér përballimin e jetesës njihen me emrin “çështje buke”.

Nuk e di nëse buka shihet me të njëjtin sy edhe në shoqëritë e tjera, por në Azerbaj-

xhan dhe në shoqëritë e tjera turke ekziston i njëjtë botëkuptim me emrin “çërek” I njëjtë botëkuptim mund të thuhet se ekziston edhe pér shoqërinë e Egjiptit. Pasi duke qenë se buka në gjuhën arabe do të thotë “hubz” egjiptasit i kanë dhënë asaj kuptimin e “jetës” që do të thotë se ata e pranojnë bukën sinonim me jetën.

Shprehja që ka përdorur Madam Antoinette në kërkesë të francezëve pér bukë në kohën e një krize ekonomike

"Nëse nuk mund të gjejnë bukë, të hajnë biskota" ngjason shumë me shprehjen *"i ngopuri nuk e kupton të uriturin"*.

Kjo do të thotë se me ndryshimin e niveleve sociale ndryshojnë edhe shijet. Si rrjedhojë një lëndë ushqimore që për dikë nuk është e dëgjuar për dikë tjetër është e zakonshme. Në fakt edhe ngatërresa ndoshta lind që këtu. Ndërkohë që një pjesë e popullatës fryhen dita ditës nga bollëku, pjesës tjetër i merret fryma nga uria dhe fakti që mungon një vetëdije mes këtyre dy grupeve tre-gon një arsyё të ngatërrresës. Natyrisht është e pamundur të barazohen nivelet ekonomike dhe sociale të njerëzve dhe të vihen të gjithë në të njëjtin pozicion. Në këtë gjithësi ligjet e natyrës dhe rregullat e drejtësisë hyjnore janë po ato. Nivelet sociale dhe ekonomike të njerëzve përcaktohen sipas përpjekjeve që bëjnë vetë ata. Nëse do të ishim si në kohën e sistemit komunist ku i afti dhe i paafti, dembeli dhe punëtori kishte të drejta të barabarta, kjo do të ishte padrejtësi e vërtetë dhe mospërshtatje me natyrën. Prodhim i një grupei që shkel rregullat etike dhe morale madje edhe ato të drejtësisë me ndjenjat e "egoizmit" dhe që mbush qeset e veta. Në këtë periu-dhë kur cënohet etika shoqërore e një sistemi shtetëror të prishur, grupe të tilla ka me shumicë.

Allahu i Lartë secilit i ka dhënë rriskun e tij pa da-



llim besimtar, mosbesimtar, mohues apo qafir dhe kjo si domosdoshmëri e emrit të Tij "Rrahman" dhe të gjitha qeniet i ka nën kujdesje si domosdoshmëri e "rriskut përgjithë botën" (shihni: Hud, 11/6) Por Allahu njofton se do t'u japë superioritet robërvë që u binden rregullave dhe parimeve të drejtësisë. (shihni: el-Enbija, 21/105)

Shfaqja e rregullave të natyrës njerëzore edhe në ma-

rrëdhëniet njerëzore sikurse gëllitja e një peshku të vogël nga një peshk i madh është një problem shumë i rëndësishëm njerëzor, temë rreth së cilës sistemet e fesë dhe të drejtësisë japin maksimalen. Fetë janë përpjekur ta bëjnë një gjë të tillë me iniciativa shpirtërore dhe parimet etike si dhe me parimet e drejtësisë të këtij sistemi.

Allahu dëshiron që të jemi të vetëdijshëm për një pafu-

ndësi mirësish që janë dhënë në rruzullin tokësor (shihni Ibrahim, 14/34) që të jemi falënderues përkundrejt këtyre mirësive dhe të mos tregoheimi mosmirënjojës (shihni Ibrahim, 14/7). Allahu njofton se do t'i shtojë mirësitë të cilat marrin falënderim (shihni Ibrahim, 14/7). Kjo rritje mund të jetë edhe materiale, edhe me shtimin e rrugëve që shfrytëzohen këto mirësi. Ajo mund të bëhet edhe nëpërmjet një rritjeje shpirtërore.

Në shoqërinë e sotme vëmëre se njerëzit e kanë të vëشتirë të sigurojnë lëndët e nevojshme të jetesës si pasojë e ngushtimit ekonomik, se ata kanë rënë në hall të sigurimit të bukës dhe rrjedhimisht jetojnë një ndjenjë serioze shtypjeje. Ka shumë arsyesh ekonomike, sociale dhe edu-

kative që krijojnë një situatë të tillë. Vendosja e shoqërisë së sotme nga një vend rural i lidhur me bujqësinë në një zonë ku jeta mbështetet në aspektin industrial nuk ka sjellë me vete edhe një bazë të shëndoshë sociale dhe etike. Në një gjëndje të tillë struktura ekonomike e deformuar në kuptimin e saj global solli ndikime shumë negative.

Njeriu dëshiroi që të konsumonte më shumë se sa prodhonte, kërkoi të bëhej menjëherë i pasur dhe të qëndronte në qoshe të vendit. Njerëzit që kishin lënë vëndin e tyre, doket dhe zakonet, filluan të jetonin më të lirë dhe më të qetë pa u ndjerë të varur prej kushteve sociale.

Ciladoqofshin arsyet, sitata e sotme është mjaft e vëشتirë. Periudha të tilla krizash janë kriza që shkaktojnë më shumë humbjen e parimeve etike dhe të identitetit të njeriut. Padyshim që të gjithë jemi përgjegjës për këtë. Drejtuesit e vendit duhet të kontrollojnë se ku kanë bërë gabim që t'i rregullojnë ato, duhet t'u hedhin një sy masave ekonomike të ndërmarrë. Kjo lidhet me drejtuesit.

Ajo për të cilën duam t'u flasim këtu është se cilat janë gabimet individuale dhe difektet shpirtërore që kanë influencuar në këtë gjendje? Për diskutimin e kësaj teme dhe kalimin e kësaj faze çështjet duhen menduar thellë si në planin individual edhe në atë shoqëror.

Allahu dëshiron që ata që besojnë dhe që kanë besim tek vetvetja ta përdorin pasurinë e tyre si një amanet dhe si një shkak për robërinë e tyre. Nëse nuk ia dimë vlerën mirësive që kemi dhe nuk i përdorim siç duhet gjëndja do të jetë e tillë. Allahu thotë në Kur'an: "**Allahu sjell si shembull një fshat (vendbanim) që ishte i sigurt dhe i qetë, të cilit i vinte furnizimi nga të gjitha anët me bollëk, kurse ata (banorët) i përbuzën të mirat e Allahut**. Atëherë Allahu, për shkak të sjelljes së tyre, ua veshi petkun (ua ngjeshi) e urisë dhe të frikës." (Nahl, 14/112) Kjo do të thotë që një nga gjërat më kryesore që e bën njeriun të lumtur në këtë botë dhe të besueshmës është një jetë larg frikës së urisë dhe një besim larg frikës së humbjes së shpirtit. Mosmirënjojja dhe humbja e vetëdijes ndaj këtyre mirësive i sjell njeriut fatkeqësi të shumta.

Ajeti kuranor që tregon se njerëzit do të sprovohen me uri dhe frikë shpreh njëkohësisht se vështirësitë ekonomike nuk burojnë vetëm nga mosmirënjojja, por ka edhe shkaqe shpirtërore dhe mistike. "**Ne do t'ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frytet, por ti përgëzoji durimtarët.**" (Bakare, 2/155) Edhe në këtë ajet ngushtimi i kushteve të jetesës dhe mëdyshja e sigurisë janë fusha ku Zoti ka testuar njerëzit.

**"Ne do t'ju
sprovojmë me
ndonjë frikë, me
uri, me ndonjë
humbje nga
pasuria e nga jeta
e edhe nga frytet,
por ti përgëzoji
durimtarët."**

Kur i hedhim një sy të sot mes vëmë re se akoma nuk jemi falënderues për mirësitë që na janë dhënë, mjafton të shohim gjëndjen e sa e sa njërezve të shtypur që vuajnë. Falënderim është të ndash mirësinë që ke dhe mosmirënjohja jonë në këtë pikë është mjaft e qartë.

Fajdja (riba), të cilën Allahu e ka cilësuar si luftë me Të dhe Pejgamberin e Tij, sot merr pothuajse plotësisht pjesën e mbledhur nga taksat e buxhetit. Kamata dhe të ardhurat që arrihen pa rrezikuar aspak janë duke tronditur njerëzit prodhues në jetën shoqërore dhe shënojnë një rritje të lartë të konsumit në jetën ekonomike, ndërsa lëndët e prodhua janë disa herë më të shtrenjta se ç'duhet për shkak të kamatës.

Në fakt janë fitimet e njërezve nëpërmjet bankave në rrugë kamate dhe jo nëpërmjet investimit dhe prodhit që tregojnë se në ç'rrugë është ekonomia. Kamata dhe interesи financiar që ndalojnë edhe çmimet e palëvizshme nuk i japin start prodhimit, por dembelizmit. Si rrjedhojë kjo situatë, që Allahu e ka ndaluar, mbyll edhe derën e begatisë të shoqërisë. Fabrika me punëtorët e saj e zhytur në humbjen me kamatë duke lënë mënjanë pagesën e borxhit që ka, ngaqë nuk është në gjëndje të pagujë kamatten përpinqet ta kalojë krizën në fjalë duke hequr punëtorë nga puna dhe duke zvogëluar kështu edhe prodhimin. Rifutja në hua e shtetit duke

**Por Allahu
njofton se do t'u
japë superioritet
robërve që
u binden
rregullave dhe
parimeve të
drejtësisë.**



bërë ndryshime në pagesën e kamatës dhe përkundrejt saj rritja e pagës së nënpunësit nën enflacion janë çështje që duhen analizuar.

Përsa kohë që njerëzit zvogëlohen nga ana ekonomike futen në telashe dhe arrijnë deri në gjendjen që nuk arrijnë t'i vënë re edhe huatë e marra për të mos rënë nën standartet e jetës. Të influencuar nga botëkuptimi **individualist** i ardhur nga Perëndimi jemi kthyer tashmë në një shoqëri me ndjenja të theksuara egoizmi, që nuk mendon për shtresën e varfra dhe nuk dëshiron të mendojmë për një gjë të tillë.

Dijetarët Islamë, nisur nga bazat e besimit, shprehen se fatkeqësitetë dhe vështirësitë e njeriut mund të kenë ar-

sye dhe urtësi të ndryshme. Vështirësitë mund të janë edhe të menjëhershme si pa sojë e një gjynahu të punuar në planin individual. Nganjëherë është synuar ngritja e tij nga ana shpirtërore. Ose i është dhënë një arsy e fortë për ta penguar ndaj një fatkeqësie edhe më të keqe.

Ne mund të arrijmë deri në atë pikë që thotë Musai (a.s) "A na shkatërron neve për shkak të gjérave që bëjnë ata që s'mendojnë? Kjo s'është gjë tjetër vetëm një provë. Kë dëshiron e largon dhe kë dëshiron e udhëzon." (el- A'raf, 7/155) Le të shpresojmë që këto vështirësi të mos janë një faturë hyjnore për ne për shkak të atyre që nuk gjykojnë dhe mendojnë!

PASURIA E VËRTETË

Sipas transmetimit të Ebu Hurejres i dërguari i Allahut ka thënë:

"Pasuria e vërtetë nuk është pasuria materiale, por ngopja shpirtërore."

Kur flitet për pasurinë zakonisht të vjen në mendje malli dhe të qenurit zotërues i një pasurie. Me të vërtetë kjo është pasuria? E thënë ndryshe, a është pasuria një çështje që fillon me bollëk dhe përfundon aty, një çështje që i përket vetëm anës materiale?

Pasuria ndjesore

Vëmë re se në hadith këtyre pyetjeve u jepen përgjigje mjaft të qarta. Pasuria e pranuar nga Allahu e cila do të ketë dobi në ahiret nuk është pasuria e marrë si sasi malli. Pasuria e vërtetë është ngopja shpirtërore, pasuria e zemrës, pa parë këtu nëse ka apo jo mall. Të bëhesh pronar i një pasurie materiale pa patur pasurinë ndjesore nuk ka asnë kuptim.

Në lidhje me këtë ka ide të ndryshme. Disa edhe pasurinë,

edhe shpirtin e kanë të ngopur. Disa kanë pasuri, por syrin e pangopur. Ata dëshirojnë të ardhura të pafundme. Ata nuk mendojnë gjë tjeter vetëm se ku dhe si të fitojnë pasuri. Të tillë sado që të kenë pasuri janë të varfër në shpirt. Disa të tjerë nuk kanë pasuri, por janë të ngopur shpirtërisht. Këta nuk e kanë mendjen tek pasuria materiale. Ata e përballojnë jetesën si të munden. Përpiken të fitojnë më tepër, por asnjëherë nuk tregohen të pakënaqur, nuk tregohen mosmirënjos, nuk e kanë syrin tek fitesa e tjetrit.

Hadithi në fjalë, duke i marrë parasysh të gjitha sa u thanë, nxjerr në dukje se pasuria e vërtetë nuk është ajo materiale, por ndjesore dhe shpirtërore duke theksuar se varfëria e atij që është i pangopur materialisht dhe shpirtërisht në të vërtetë është një grykësi e vërtetë nëse nuk zëvendësohet me bollëkun material.

Le të theksojmë edhe njëherë se hadithi nuk refuzon të qenurit i pasur nga ana materiale, por është kundër mendimit se bollëku material është pasuria

e vërtetë. E thënë ndryshe ai jep një mesazh të qartë: "Sado të jemi të pasur materialisht bëni kujdes të keni shpirtin e ngopur dhe zemrën e pasur." Pasi pasuria e vërtetë është të falënderosh dhe të mos kesh ambicje të kësaj bote.

Baza e pëlqimit

Ngopja shpirtërore mbështetet në pëlqimin në dhuntinë që Allahu të ka dhënë. Kjo është pasuria më e madhe. Pasi përfundimi i saj është dorëzimi tek Allahu. Kjo do të thotë të pranosh përcaktimin e Allahut si më të dobishmen përvete. Prandaj ngopja shpirtërore e bën njeriun të tregohet i matur në kërkësat e tij dhe t'i mbështet vetëm Allahut. Kjo është edhe pasuria e vërtetë. Është liria e vërtetë dhe nderi më i lartë.

Mospëlqimi ndaj asaj që të ka dhënë Allahu të shtyn në ambicje, në mosnjohje kufiri dhe në mosbindje që nuk ka fund. Kështu për njeriun fillon një varfëri brenda pasurisë.

Kolonializmi

Një tjetër rezultat i ambicjes



dhe mosbindjes është kolonializmi në planin individual dhe shoqëror.

“Zhvillimet” e kolonialistëve në botë në aspektin teknik nuk duhet të mashtrojnë askënd përsa i përket pasurisë së vërtetë. Këta të pangopur që pandehin se pasuria e vërtetë është “bollëku material” bëjnë shpenzime dhe propogandë të paparë për të shtuar numrin e popullatës së shtypur me mëdyshjen se do bëhen pengesë e ngopjeve të pangopshmërive dhe ambicjeve që sa vijnë e rriten. Ata jetojnë me frikën se një ditë do mbisin të uritur.

Disa që mbisin pre e djallëzisë së propogandës së këtyre popujve kolonistë dhe të pangopur e anashkalojnë garancinë hyjnore dhe detyrat e tyre kryesore të përcaktuara në ajetet:

“Rriskun në sipërfaqen e tokës e ka marrë përsipër Allahu.” “Xhindët dhe njerëzit i krijova vetëm të më adhuronin Mua. Unë nuk pres rrisk prej tyre, as nuk pres të më ngopin.”

Bota duhet të jetë në duart tona

Duhet të theksojmë këtu që falënderimi është të përballosh jetesën me atë që ke në dorë dhe jo të mjaftohesh. Të fitosh më tepër dhe të përpinqesh të prodhosh nuk është në kundërshtim me falënderimin. Por nuk duhet të kemi ambicje përtë fituar pakufishmërisht. Këtë çështje të mëdhenjtë e Islamit e kanë shprehur kështu:

“Bota duhet të jetë në dorën tende, por jo të futet në shpirtin të tend.”

Me sa duket kjo është edhe pasuria e vërtetë. Ai që ka shpirtin e ngopur di ta shpenzojë atë që zoteron. Ndërsa kush është i uritur apo tejmase dorështrënguar nuk i jep gjë askujt madje vetë nuk di ta shfrytëzojë mjafshëm atë që ka. Pasuria e një individi të tillë natyrshëm nuk mund të quhet “pasuri”

Në një tjetër hadith profetik thuhet: **“Ka shpëtar ai mysliman që ka një ekonomi të mjafshëm dhe di ta falënderojë Allahun për atë që i ka dhënë.”** dhe tregohet se besimi, ekonomia dhe morali janë çështje të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

Ngopja shpirtërore do të thotë të mjaftohesh me atë që ke shpirtërisht dhe praktikisht, të mos cënosh të drejtë e askujt, të mos dalësh jashtë vijës së besimit dhe drejtësisë dhe mos bëhesh skllav i materies. Pra në një kuptim ngopja shpirtërore është të mos i hapësh rrugë kolonializmit.

Pas bukurive

Nga ana tjetër ngopja shpirtërore e nxit njeriun të shpenzojë kohën e tij për gjëra të pjekura dhe të bukura. Këto përparësi të vazhdueshme padyshim që për njeriun janë më të dobishme dhe më të domosdoshme se pasuritë materiale për të cilat njeriu është bërë rob.

Përpjekjet e treguara për shkencë dhe pjekuri epshorre janë përpjekje për të arritur në pasurinë e vërtetë. Pasuria harxhohet dhe zhdukët për një kohë të shkurtër, ndërsa shkenca është një thesar që s'mbaron asnjëherë. Kështu një dijetar këtë të vërtetë e pati shprehur kështu...

Jemi dakort me ndarjen tande o Xhebbar,

Neve na jep shkencë, armiqve mall...

Brenda një kohe të shkurtër konsumohet ky mall,

Shkenca është e përjetshme, kurrë nuk pëson gjë!

E vërteta e sotme

Në ditët e sotme, ku lufta e ndarjes së vlerave ekonomike të botës ka arritur kulmet e saj, është mëse e domosdoshme t'i shpjegohet njeriut të sotëm, i cili është i lodhur nga të menduarit mëngjes – darkë për ekonominë, se pasuria e vërtetë e të qenurit i ngopur në atë mënyrë që i takon nderit të njeriut është lumturia e vërtetë. Rrugëzgjidhja më njerëzore e ngatërresave dhe e korruptionit material është ta afrosh njeriun drejt pasurisë ndjesore që quhet edhe **pasuri shpirtërore**.

Nxitja drejt përfitimeve poshtëruese, si të ishin zgjidhje e vetme, ndërkohë që nuk bëjnë askënd të lumtur, do të thotë që shoqëritë të përgatisin me duart e tyre fatkeqësítë materiale dhe perfundimet e dhimbshme. Pa u arritur një drejtim etik dhe një disiplinë për këtë rrugëtim të pakuptimitë nuk do të ketë dobi asnjë paketë ekonomike.

Më shumë se për të dhënët ekonomike kemi nevojë për parime etike drejt ekonomisë. Sepse pasuria e vërtetë nuk është ekonomia, por pasuria morale. E thënë ndryshe me shprehjen e hadithit:

“Pasuria e vërtetë nuk është pasuria materiale, por ngopja shpirtërore.”



AGJÉRIMI DHE DEVOTSHMËRIA

Allahu xh.sh. në Kur'an thotë: "O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim ashtu sikurse qe obligim edhe për ata që ishin para jush, me qëllim që të bëhuni të devotshëm." (Bekare, 183)

Agjërimi synon të ngre besimtarin në shkallën e devotshmërisë.

- Të devotshëm janë ata që ruhen nga dënim i Allahut, duke u distancuar prej gjérave që i ka ndaluar Allahu xh.sh. dhe duke zbatuar urdhrat dhe detyrimet e tyre që kanë ndaj Zotit xh.sh..

- Të devotshëm janë ata që largohen prej gjynaheve;

- Të devotshëm janë ata që ruhen nga shirku (idhujtaria), ndërsa adhurimin e kanë të sinqertë ndaj Allahut të Lartësuar.

- Të devotshëm janë ata që kanë frikë Allahu xh.sh.më

shumë se çdo gjë tjetër.

Allahu i madhëruar urdhëron e thotë: "O njerëz, adhurojeni Zotin tuaj, i cili ju krijoj juve edhe ata që ishin para jush, në mënyrë që të jeni të devotshëm (të shpëtuar)." (Bekare, 21)

Një njeri shkoi te Pejgamberi a.s. dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, më këshillo!"

Pejgamberi a.s. i tha: "Të këshilloj që të jesh i devotshëm ndaj Zotit xh.sh."

Pra agjërimi i muajit të Ramazanit është bërë obligim me qëllim që ne të jemi të devotshëm. Nëse nuk e arrijmë këtë, do të thotë që nuk kemi agjëruar siç duhet.

Agjërimi, si një detyrë fetare, është një begati hyjnore, një rast shumë i çmuar për njerëzit të cilët arrijnë të agjerojnë. Megjithatë agjërimi ka edhe vështirësitë e tij. Të gjitha

veprat e mira dhe të dobishme nuk arrihen pa vështirësi dhe mund.

Pejgamberi a.s. ka thënë: "Kush agjeron Ramazanin me bindje dhe shpresë në shpërblimin hyjnor, i falen gjynahet e bëra." Pesë namazet, prej xhumasë në xuma dhe prej Ramazanit në Ramazan falin gjynahet, përvëç atyre të mëdhave." (Muslimi)

Pejgamberi a.s. na përgëzon dhe thotë: "Vërtet, në xhenet është një derë, e cila quhet Rejan, nëpër të cilën do të hyjnë në Ditën e Gjykimit vetëm ata që agjerojnë. Nëpër atë derë të tjerët nuk do të hyjnë. Do të dëgjohet nga ajo derë thirrja se ku janë agjéruesit. Do të hyjnë brenda agjéruesit dhe nuk do të mund të hyjë askush tjetër nga ajo derë." (Buhariu)

Transmetohet nga Ebu Hu-rejra se Profeti a.s. ka thënë: "Agjërimi është mburojë, kur



“O njerëz, adhurojeni Zotin tuaj, i cili ju krijoi juve edhe ata që ishin para jush, në mënyrë që të jeni të devotshëm (të shpëtuar).”

(Bekare, 21)

ndonjëri prej jush agjëron nuk duhet të flasë fjalë (të këqija) dhe të veprojë vepra të pahijshme. Kur dikush e godet apo e shan, le të thotë: ‘Kam agjèruar, kam agjèruar.’ Pasha Atë në dorën e të cilit është vetja ime, era e gojës së agjéruesit tek Allahu është më e mirë se era e miskut.”. (**Buhariu Muslimi**).

Hudhejfe ka thënë se ka dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: “Sprovën e personit në familjen e tij, pasurinë e tij, fqinjin e tij, e fshijnë namazi, agjërimi dhe sadakaja”.

(Buhariu Muslimi).

Agjërim do të thotë arritje e gjendjes takva (devotshmëri, vetëdijskëmëri mbi Allahun

xh.sh.). Takva do të thotë të veprosh në përputhje me urdhërat e Allahut xh.sh. dhe të distancohesh nga ndalesat hyjnore.

Agjërimi është mënyra më e mirë që e ndihmon njeriut të përm bushë detyrat e Islamit.

Dijetarët kanë përmendur disa nga arsyet pse Allahu xh.sh. e bëri agjërimin farz. Të gjitha këto kanë të bëjnë me devotshmërinë.

– Agjërimi na bën të dijmë të vlerësojmë dhe të falënderojmë për mirësitetë në këtë jetë. Pasi që agjërimi nënkupton largimin nga ngrënia, pirja dhe marrëdhinet, të cilat janë nga kënaqësitë më të mëdha, largimi nga ato për një kohë të shkurtë, na bën të dijmë vlerën e tyre.

– Agjërimi nënkupton largimin nga gjërat të cilat Allahu xh.sh.i ka ndaluar.

– Agjërimi na bën të ndjejmë dhe të kuptojmë të varfërit, sepse, kur personi i cili agjeron ndjen dhimbjen e urisë, ai përkujton ata njerëz të cilët

janë në atë gjendje tërë kohën, kështu që ai do të jetë i shtyrë të sillet mirë ndaj tyre dhe të ndjejë gjendjen e tyre. Agjërimi nënkupton edukimin e njeriut që ai të ndjejë situatat ku jeton i varfëri dhe të sillet mirë me ta.

– Agjéruesi ushtron vehten e tij që të jetë i vetëdijskëm se All-lahu e mbikqyr atë çdo moment, kështu që ai largohet nga gjërat të cilat i lakmon edhe pse është në gjendje t'u afrohet apo t'i shfrytëzojë ato, sepse e di se All-lahu e sheh atë edhe pse ai nuk e sheh Atë.

– Agjërimi e nxit muslimanin të kryej edhe më tepër vepra adhurimi.

Lusim Allahun xh.sh. të na ndihmojë ti kryejmë këto obligime dhe të na mundësojë që ta adhurojmë. Atë me dinjitet dhe devotshmëri.

Zoti ua shpërbleftë!

Një histori prekëse dhe rënqethëse, por mjaft domethënëse dhe kuptimplotë. Për të do të ishte dita më e errët e jetës së tij, por sa do të donte të ishte e zakonshme kur doli në rrugë si përherë megjithëse ishte kohë telashesh dhe problemesh serioze për kohën ku jetohej. Ishte përgatitur si përherë të dilte në rrugët e qytetit ku natyrisht nuk kishte harruar të merrte edhe duanë e nënës e

cila si çdo zemër nëneje i qëndronte shumë pranë jo vetëm atëherë kur ndodhej aty, por edhe kur nuk ndodhej. Ajo e falëndëronte Zotin që i kishte dhënë një fëmijë të tillë dhe që natyrisht ia kishte lehtësuar mjaft punën e saj pasi ky fëmijë kishte një edukatë disi më ndryshe. Kjo sepse eëma lutej çdo moment që Allahu i lartë t'i hapte dyert e jetës duke u mbështetur edhe në një ajet Kuronor:

"Padyshim, Ne do t'i shpërblejmë ata të cilët falënderojnë." (Al-i Imran, 145)

Por ajo ditë nuk vazhdoi ashtu siç nisi, por krejt ndryshe nga ç'mendohej. Një fatkeqësi e madhe do ta ngacmonte fëmijën shembullor të asaj nëneje. Një fatkeqësi do ta prekte thellë në shpirt ku për një moment do të dukej sikur po humbiste çdo shpresë për të jetuar, por ja që besimi i pashmangshëm tek Kri-

**"Vetëm Ty të adhurojmë
dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë"**

(el-Fatiha,4)



juesi i gjithësisë do ta bënte akoma edhe më të fortë sepse edhe një ajet Kuranor do të bëhej një mbështetje e fortë për të ardhmen:

“Padyshim që Allahu është me të duruarit.”

Por ç'ndodhi atë ditë? Një granatë e vendosur diku aty përtej do t'i merrte gjënë më të shtrenjtë që ka njeriu, sytë e ballit dhe kështu djaloshi në moshën më të bukur të tij do të humbiste shikimin dhe nuk ishte diçka e thjeshtë për t'u kaluar ashtu si hiç gjë pasi në atë moment bota e errët i thoshte "mirëse erdhe këtu", aty ku në fakt askush nuk do të dëshironte të ishte. Por ja që fati ishte i tillë. Ishte një moment që tashmë dukej se apo kishte nisur dhe s'do të mbaronte kurrë. Njeriu në situata të tilla kërkon të gjejë mbështetje diku, të mbahet pasi bota e errësirës është e pamëshirshme. Gjithsesi nuk mposhtej asnjëherë përkundrazi një vullnet i brendshëm e mbante gjallë, një thirrje hyjnore i lëshonte një rreze drite në shpirt duke e qetësuar dhe duke i dhënë shpresat të forcohet shpirtërisht pasi ditët në vijim ishin ditë lufte dhe sakifice përtë. Një nismë e re e një programacioni televiziv do të bënte që djaloshi të merrte një rrugëtim të ri dhe jeta e

ti j të ndryshonte pse jo tërësisht. Shumë shpirtra bamirës do të bëheshin nismëtarët në jetën e tij gjatë këtij rrugëtimi duke i thënë djaloshit se nuk je i vetëm dhe se mëshira e Allahut është me ty. Në fakt nga shpërthimi i asaj granate djaloshi kishte shpëtuar dy jetë njerëzish dhe lidhur me këtë vetë Kurani thotë:

“Kush shpëton një jetë njeriu është si të ketë shpëtuar gjithë njerëzimin”

Ai ndjehej krenar që kishte arritur një gjë të tillë, prandaj dhe u bë objekt bisëde për shumë familje shqiptare që të ndihmohej dhe të rikthehej përsëri në botën aktuale ku tashmë nuk ishte thjeshtë vetëm gjiri i familjes që e priste, por i gjithë populli.

Ishte rreth të gjashtëdhjetat dhe me një paraqitje të përfisnik zonja me të cilën u takuam rastësisht para ca kohësh. Jeta e saj kishte klluar nëpër shumë tatëpjeta dhe pothuajse në një vëmi të plotë. Një histori sa e dhimbshme dhe dramatike, ndoshta nga më të rrallat të dëgjuara deri më sot. Një shpirt fisnik me një guxim të paparë dhe vullnet të pa shoq kishte triumfuar nëpër shkallët delikate të kësaj jete që për shumë njerëz ka qenë



edhe mizore dhe e pamëshirshme. Në fytyrat e saj ishin mjaft të dukshme rudhat e njëpanjëshme që në fakt të jepnin përshtypjen e një moshe të rënë, por ja që e vërteta nuk ishte e tillë, pasi në fakt ajo kishte rënë fizikisht duke u përballur me shumë sëmundje, por shpirtërisht vazhdonte të qëndronte e fortë duke u mbajtur përherë në dy patericat që kishte në duar. Nga goja e saj dilnin lutje nga më të ndryshmet, por ajo që të bënte përshtypje ishte shprehja dhe ajeti i njo-hur i sures "el-Fatiha" i cili thoshte:

“Ijjake na’budu ve ijake nestaijn” kuptimi i së cilit ishte

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë” (el-Fatiha,4)

Ajo nuk dëshironte asnjëherë të binte në dorën e dikujt tjetër pasi e kishte kuptuar që me kohë se vetëm Zoti një dhe i vetëm e ndih-

monte edhe në momentet më të vështira të jetës, pasi pavarësisht nga vuajtjet dhe mundimet që kishte kaluar ajo belbëzonte vetëm falënderim për Krijuesin e Gjithësisë. Me të vërtetëjeta i kishte kaluar në vetmi dhe në sakrifica të shumta, por ajo që kishte kuptuar ishte shumë më tè për se “**të Zotit jemi dhe tek Ai do kthehem**”

Ditët ecnin me hapa të shpejtë, por djaloshi 14 vjeçar nuk arrinte t'i përshpejtonte hapat e veta. Megjithëse në një moshë tepër delikate në të cilën çdo adoloshent kishte ëndrra dhe dëshira të pakufijshme, ai nuk guxonte të ëndërronte pasi nuk ishte si të tjerët. I mbetur jetim mes katërr rrugësh, i strehuar në një shtëpizë që vetëm e tillë nuk mund të ishte çdo ditë

jetonte me vështirësitë e jetës dhe me goditjet e saj. Shokët e tij të klasës ishin bërë një dorë mbështetëse për të. Sytë e tij rrezatonin dritë pasi në fakt ai asnjëherë nuk i kishte humbur shpresat dhe kishte një besim të fortë në vetvete se një ditë do të vinte që edhe ai të gjëzonte sikurse moshatarët e tij. Ai megjithëse ndodhej në një pozicion të tillë mundohej në çdo kohë dhe moment të tregohej i sjellshëm dhe i kulturuar duke ndjekur kështu këshillat e të ndjerëve prindërve të tij të cilët nuk jetonin më. Edhe pse në një situatë të tillë ai nuk kishte devijuar nga rruga e drejtë, ajo e përcaktuar nga Allahu i Lartë, përkundrazi besimi dhe vullneti për të vazhduar në një rrugë të tillë sa vinte e i forcohej akoma edhe më shumë. Jeta i kishte

mësuar shumë gjëra në thelbin e të cilave qëndronte devotshmëria dhe guximi për të përballuar vështirësitë dhe mirënjoyja për ata që i qëndronin pranë.

Kështu një ditë prej ditësh për të do të ndryshonte gjithçka dhe buzëqeshja do të rikthehej përsëri dhe këtë herë padyshim që krejtësisht ndryshe pasi nuk do të vuante më si më parë, por këtë herë sakrificat do të ishin akoma edhe më të shumta. Shokët e tij të klasës me anë të një surprize të përgatitur enkas për të do ta kalonin në një institucion që do të kontribuonte për shumë kohë për djaloshin 14 vjeçar qoftë nga ana shpirtërore qoftë edhe nga ana ekonomike. Allahu i Lartë ia kishte pranuar lutjet e tij ndër të cilat shprehej:

- O Zoti im! Më bëj mua prej besimtarëve dhe të devotshmëve.

Ishin këta njerëz që i ndryshuan jetën, që i hapën dyert e zemrës së tyre për një edukim më të mirë dhe më të rehatshëm. Ata i kthyen buzëqeshjen këtij djaloshi duke e ditur se edhe një hadith i profitetit është:

“Edhe buzëqeshja është sadaka.”

Të bësh mirësi është një obligim dhe domosdoshmëri për çdo njeri që i thotë vetes besimtar i devotshëm. Por mirësia nuk mund të kuptohet thjeshtë vetëm ndihma ekonomike apo materiale pasi njeriu është një qenie e



tillë që pikësëpari ka nevojë për ngrohtësi shpirtërore. Ka nevojë të gjejë prehje emocionale diku dhe pse jo edhe më ndryshe se një ditë më parë. Në një ajet Kur'anor thuhet:

"Zoti është bujar dhe bujaret i do" ashtu sikurse thuhet edhe në një vend tjetër:

"Zoti është i mirë. Mirësinë dhe bukurinë e do"

Një nga virthitet më të larta të shoqërisë sonë padyshim është edhe mikëpritja dhe bujaria me të cilat domosdo krenohemi pasi në këtë mënyrë respektojmë individë dhe mentalitete të ndryshme që në fund të fundit janë pjesë e jona, janë qenie njerëzore sikurse dhe ne. Prindërit tanë vihen në gadishmëri të plotë për të përcjellur tek mysafirët ngrohtësi dhe modesti dhe

kjo jo vetëm thjeshtë nga ana materiale nëpërmjet shtrimit të tryezës me llojshmëri ushqimesh, por edhe me një ngrohtësi familjare të paparë ndoshta deri në atë kohë, mjafton të jetë qëlimi i mirë dhe begatia nuk mundon pasi edhe një hadith i profetit thotë:

"Veprat vlerësohen sipas qëllimit."

Një tryezë e shtruar në mënyrë tepër modeste tregon një sjellje të hijshme të familjarëve nisur edhe nga thënia Kur'anore:

"Hani, pini dhe mos e teproni"

Natyrs'hëm, njeriu gjen vreten në një mikëpritje të tillë dhe këto ndjenja i transmeton kudo që të shkojë.

Shumë vuajtje jetojnë njerëzit në planetin tokë, shumë njerëz vuajnë nga sëmundje të pashërueshme, nga uria, nga skamja, nga varfëria...

Janë me mijëra e mijëra njerëz që nuk kanë as kushtet më minimale të jetesës për ta quajtur veten njeri...

Sa fëmijë vdesin në hapat e parë të jetës së tyre, sa të rinjë vuajnë nga mungesa shpirtërore e prindërvë, sa fëmijë të gjymtyruar rropaten nëpër



rrugë të pastrehë....

Sa të tjerë janë që kërkojnë lëmoshë duke e bërë këtë pse jo edhe një profesion të tyrin...

Sa zemra dhe shpirtra njerëzish vuajnë nga dhuna psiqike dhe fizike. Sa të tjerë flijojnë veten nga depresioni

Por jeta vazhdon...

"Kush shpëton një njeri është si të ketë shpëtuar gjithë njerëzimin"

Le të bëhem i pishtar të këtij ajeti duke i zgjatur dorën e ndihmesës njerëzve që në fund të fundit do luten për ne. Le të jemi edhe ne pjesë e një kontributi modest dhe t'u japid jetë zemrave të vuajtura.

**"Padyshim,
Ne do t'i
shpërblejmë
ata të cilët
falënderojnë."
(Al-i Imran, 145)**

Domethënia besimore e përshëndetjes islame “es-selamu alejkum”



“O ju që besuat, mos hymi në shtëpi të huaja pa kërkuar leje dhe pa përshëndetur njerëzit e saj (me selam). Kjo është më mirë për ju në mënyrë që të merrni mësim”

En-Nur: 27



1. Përkufizimi i formës së ‘selamit’ si përshëndetje

‘Selami’ është shprehje (përshëndetje) unikate për të gjithë pjesëtarët e Islamit. Ai shprehet në gjuhën arabe. Forma e plotë e përshëndetjes islame ‘selam’ është kështu: i pari i cili e fillon përshëndetjen thotë: ‘es-selamu alejkum’, dhe mund t’ia shtojë pjesën: ‘ve rahmetullahi’, domethënë: es-selamu alejkum ve rahmetullahi. Ndërsa, i dyti që e kthen përshëndet-

jen, thotë: ‘ve alejkum selam ve rahmetull-Llah’, dhe sipas mundësisë i shtohet edhe pjesa ‘ve berekatuhu’. Sepse, më së paku, duhet këthyer përshëndetjen e njëjtë, ndërsa më së shumti (e mira e të mirës) është që përshëndetja t’i kthehet duke ia kapërcyer, e kjo bëhet duke ia shtuar në fund fjalën ‘ve berekatuhu’. Ky konstatim, ka mbështetje në ajetin kur'anor, ku Allahu i Madhëruar i porositë besimtarët se:

“Kur përshëndeten me ndonjë përshëndetje, ju ktheni përshëndetje edhe më të mirë, ose kthenie ash-tu. Allahu llogarit për çdo send.” (Kur’ani, En-Nisa:86)

2. Domethënia e përshëndetjes “es-selamu alejkum”

Përshëndetja islame ‘selam’ me të vërtetë ka domethënie të gjerë. Ajo karakterizohet me një kuptim unikat në gjuhën arabe, ndërsa përkthimi i saj bukval në gjuhën shqipe,

po thuajse është i pamundur. Kur i hapim fjalorët e gjuhës, vërejmë dhe vërtetojmë se nocioni 'selam' ka më shumë se një, dy, tre, katër, pesë e më tepër kuptime tejet domethënëse. Teufik Mufticí, ne lidhje me domethënien e nocionit 'selam' numron këto kuptime. Sipas tij 'selam' do të thotë: të jesh shëndosh e mirë; të jesh i padëmtuar; i sigurtë; i dëlirë, i panjollë, shembullor; të jesh besnik, të dëshmohesh; të jesh i përkushtuar (Zotit); shpëtim; mirëqenie; paqeje, etj.¹Përveç kësaj, 'selam' është edhe fjalë e Allahut të Madhëruar: "...Selam, thënie e Zotit Mëshirues" (Jasin:58). Edhe më shumë, 'selam' është edhe njëri nga emrat e buktur të Allahut të Madhëruar.

3. Bazat e 'selamit' si përshëndetje

Allahu i Madhëruar, në Kur'an i porositë besimtarët që kur të hyjnë në ndonjë shtëpi të huaj, të marrin leje nga familjarët dhe në kontaktin e parë me ndonjërin prej tyre, t'i përshëndesin me 'selam':

"O ju që besuat, mos hyni në shtëpi të huaja pa kërkuar leje dhe pa përshëndetur njerëzit e saj (me selam). Kjo është më mirë për ju në mënyrë që të merrni mësim"

(Kur'ani, En-Nur: 27)

Pejgamberi s.a.v.s. në thënie të tij, ndërsa na mëson rregullat e mirësjelljes, thotë se dhënia dhe pranimi i 'selamit' konsiderohet prej 5 detyrime-

1. Teufik Mufticí "Arapsko – srpskohrvanski rječnik", Sarajevë, 1984, botimi i dytë, vëll.I, fq. 1558-1560.



ve që muslimani i ka ndaj muslimanit: "Muslimani ndaj muslimanit i ka pesë obligime: kthimin e selamit, viziten e të sëmurit, faljen e namazit të xhenazes, përgjigjen ndaj ftesës së tij dhe lutjen përmëshirë nga Allahu kur teshtit."² Pastaj hadithi tjetër:

"Nuk do të hyjni në xhennet derisa të besoni, dhe nuk do të besoni derisa të duheni në mes veti. A doni t'ju tregoj përmirë gjë, që nëse e vepronoi do të duheni: jepni selam në mesin tuaj."³

Dhe hadithe të tjera.

4. Umeti islam dhe përshëndetja 'es-selamu alejkum'

2. Sahihul Buhari, kitabu'l-xhenaizi (babu: el-emru bit-tibai'l-xhenaizi), hadithi nr. 1164.

3. Sahihu'l-Muslim, Kitabul imani, (babu: bejanu ennehu la jed'hulul xhennete illel muminune) hadithi nr. 81 (citim sipas CD-sës).

Secili popull ka veçoritë dhe identitetin e vet. Umeti i Muhamedit a.s. pa marrë parasysh largësitë territoriale dhe të kufijve apo dallimet e tjera, është një dhe unikat në pikëpamjet e fesë, sepse ka një besim, një moral fetar, andaj edhe e ka përshëndetjen e vet të vaçant që njihet me emërtimin 'selam'. Me këtë, dëshiroj të potencojo se përshëndetja islame 'es-selamu alejkum' nuk është pronë e asnjë populli apo kombi. Ndonëse është në gjuhën arabe, ajo nuk është e arbëve në mënyrë të vaçant. Në të vërtetë aq sa kanë të drejtë arabët, që të pretendojnë se ajo është përshëndetja e tyre, po aq ka të drejtë çdo komb tjetër, pjesëtar i fesë islame, që të thotë se ajo është e tyre. Sepse 'selami' është 'gjuha' e fesë islame dhe me të mund

të komunikojnë dhe duhet të komunikojnë të gjithë ata që Islamin e njohin për besim të tyre dhe fe të tyre.

Le ta themi edhe këtë, se kombi arab ka përshëndetjet e veta eskluzive, sikurse çdo komb tjetër, p. sh. Mirëmëngjes (sabahul hajr), miredita (neharukum se'idun), mirëmbërëma (lejletukum se'itetun), mirupafshim (ilel-likai) etj. Të njëjtat përshëndetje i kemi edhe ne si komb shqiptar. Pa dyshim edhe këto konsiderohen përshëndetje, porse në krahasim me përshëndetjen e 'selamit' nuk krahasohen dot.

Pretendimi paradoksal se përshëndetja islame e 'selamit' është e ndonjë kombi të caktuar, është e barbartë sikur të themi se Kur'anë ësh-



të i ndonjë kombi të caktuar apo saktësisht, i arabëve për se ka zbritur në gjuhën arabe, apo edhe më paradoksalisht të themi se feja islame është e kombit arab, për shkak se Kur'anë është në gjuhën arabe dhe se Pejgamberi është nga gjiri i tyre. Kjo nuk qëndron absolutisht. Madje pohimi i këtillë, tregon cekshmërinë e njohurive në raport me njohjen e fesë islame. Këmbëngullësia në këtë paraqet një gabim sa të panevojshëm aq të pajustifikueshëm.

Definitivisht, përshëndetja islame, 'selam' është e të gjithë muslimanëve pa dallim ngjyre, kombi, fisi apo gjinie, për arsyen e vetme, sepse është përshëndetje fetare dhe buron nga Kur'anë dhe Sunneti i Resulullahit s.a.v.s.

5. Historiku i përshëndetjes islame 'selam'

'Selami' ka një histori të gjatë te njerëzimi në përgjithësi. Realisht ajo është e vjetër sa edhe vetë njeriu. Në hadithe të Pejgamberit a.s. vërtetohet se prej normave morale të mirenjelljes, që Allahu i Madhëruar i pati mësuar njeriut të parë Ademit a.s., menjëherë pas krijimit të tij, kishte qenë edhe mësimi i përshëndetjes 'es-selamu alejkum'.

"Pasi që Allahu e krijoi Ademin a.s. i tha atij: shko dhe jepju selam atij grapi të melaqeve që qëndrojnë ulur dhe dëgjoji mirë se si po ta kthejnë përshëndetjen, sepse ajo do të jetë përshëndetja jote dhe e pasardhësve tu. Ai (Ademi a.s.) u tha: es-

*selamu alejkum!" Ata ia kthyen: es-selamu alejke ve rahmetullahi. Pra ia shtuan fjalën 've rahmetull-Llahi'."*¹

Ky hadith na qartëson dy të vërteta: 1. të vërtetën, se 'selami' historikisht prinë ndaj çdo forme tjetër të përshëndetjeve, dhe 2. se 'selami' si përshëndetje nuk fillon vetëm me zbritjen e Kur'anë dhe dërgimin e Muhamedit a.s. për pejgamber, por ajo është shumë e herëshme. Ky është edhe një argument shtesë se 'selami' nuk është aspak përshëndetje eskluzive e arbëve, por e të gjithë njerëzve (musilimanëve), sepse Ademi a.s. është babai i të gjithë njerëzve.

6. 'Selami' si përshëndetje është obligim për muslimanët

'Selami', pa dyshim konsiderohet prej çështjeve obligative për muslimanët. Në konceptin islam, përshëndetja islame 'selam' është e pa-zëvendësueshme me asnje përshëndetje, sepse është përshëndetje që Allahu e ka urdhëruar, kurse i Dërguari i Tij s.a.v.s. na ka mësuar se si ta aplikojmë në jetën tonë të përditshme. Aplikimi i tij, nuk është çështje vullneti, por është çështje urdhëri dhe detyrimi. I Lartëmadhëruari në Kur'an thotë:

"Kur të hyni në ndonjë shtëpi përshëndetni (ata që janë në to) me një përshëndetje të caktuar nga Allahu

1. Sahihul Buhari, Kitabul-isti'dhan (babu: bedeu's-selam), hadithi nr.5759. (citim sipas CD-së).

(me selamun alejkum) që
është e bekuar dhe e kënd-
shme.” (En-Nur:61). Edhe
Pejgamberi a.s., e ka obliguar
përshëndetjen me ‘selam’.

“Na ka urdhëruar Pejgamberi
s.a.v.s. për shtatë gjëra dhe na ka
ndaluar nga shtatë të tjera. Na
ka urdhëruar për: vizitën ndaj të
sëmurit, faljen e namazit të xhe-
nazës, lutjen për shëndet ndaj
atij që teshtit, kthimin e selamit,
ndihmën ndaj të të dëmtuarit,
përgjigjen ndaj ftuesit dhe përb-
ushjen e betimit.”¹

Ndërsa në një hadith tjetër,
Pejgamberi a.s., urdhëron që
'selami' si përshëndetje, të
prijë para çdo bisede tjetër.
Ai thotë: “Kush ju flet juve
para se t'ju japë selam, mos iu
përgjigjuni derisa të fillojë me
selam”.²

7. 'Selami' është përshëndetja e banorëve të xhennetit

Përshëndetja islame 'selam',
përpos që është përshëndetje
e muslimanëve në këtë botë,
ajo është përshëndetje edhe
e banorëve të xhennetit. Në
dhjetëra vende në Kur'an,
Allahu ka vërtetuar se banorët
e xhenetit, do të përshë-
ndeten me 'selam'. Engjëjt do
t'u thonë:

**“selamun alejkum, me du-
rimin tuaj gjetët shpëtimin,
sa përfundim i lavdishëm
është ky vend”** (Kur'an, Er-
Rra'd:24). Ndërsa Pejgamberi



a.s. ka thënë:

“Adhurojeni të Gjithëmëshir-
shmin, jepni ushqim dhe jepni
selam, do të hyjni në xhennet
me selam.”³

8. Domethënia besimore e 'selamit' dhe epërsia e tij mbi çdo përshëndetje tjetër

Deri këtu, përgjithësisht i
kemi pa specifikat e përshë-
ndetjes islame 'es-selamu
alejkum'. Kemi vërejtur se,
'selami' si fjalë është thënie e
Allahut të Madhëruar; se ai
ka domethënie të gjerë dhe
shumë përmbajtësore; se 'se-
lamë' është përshëndetja e
parë e njeriut të parë Ademit
a.s.; se 'selami' është përshë-
ndetja e melekëve që i kanë

bërë Ibrahimit a.s.; se 'selami'
është përshëndetja për Pejga-
mberin a.s.; se 'selami' është
përshëndetja për të vdekurit,
se 'selami' është përshëndet-
ja e banorëve të xhennetit; se
'selami'..., me një fjalë dhe
mbi të gjitha është ashtu si-
kurse thotë Allahu i Madhë-
ruar në njërin prej ajeteve që
e kemi cituar më lartë: **‘është
një përshëndetje e caktuar
nga Allahu, e që është e be-
kuar dhe e këndshme.’**

Nuk janë vetëm këto ve-
çoritë e 'selamit' si përshë-
ndetje. Jo, ato janë akoma
më shumë që ne, disa mund
t'i identifikojmë e disa nuk
mund t'i dimë. Një është me
rëndësi se përshëndetja islame
'es-selamu alejkum' është
unikate, e veçantë, me vlerë
të pazëvendësueshme dhe e
pa krahasuar me asnjë për-

1. Sahihul Buhari, Kitabul medhalimi vel
gasbi (babu: nasrul madhlumi), hadithi nr.
2265.

2. Muttefikun alejhi, sipas: Ebu Beker
El-Xhezairi, "Minhaxhul Muslim", op.cit.
fq.101.

3. Suneni i Termidhiut, kitabul-et'imeti
an Resulilahi (babu: ma xhae fi fadli if'amita-
tëami), hadithi nr. 1778. Transmetuesi tho-
të se hadithi është 'hasenun sahihun' – i
vërtetë në shkallën 'i mirë'.

shëndetje tjetër nga formulimet njerëzore. Le të pyesim, cilat janë ato vlera besimore (akaidore) që ‘selamin’ si përshëndetje e bëjnë të veçantë dhe atraktive? Prej vlerave besimore më kryesore janë tri sosh:

1. ‘Selami’ është reflektim i besimit stabil në Allahu i Madhëruar.

Fakti se ‘selami’ është vëçanti e muslimanëve dhe me të nuk lejohet t’i përshëndetim jo muslimanët, tregon se e vërteta e tij, mbi të gjitha, është një e vërtetë besimore. Pranimi i konceptit të ‘selamit’ si përshëndetje, është njëkohësisht edhe pranim i besimit islam dhe, e kundërtë, refuzimi i tij, është refuzim i një vlere që ka rëndësi fetare dhe besimore.



Për asnje përshëndetje tjetër, Allahu nuk ka thënë se është përshëndetje prej Tij, përpos për ‘selamin’. Po ash tu për asnje përshëndetje tjetër Allahu i Madhëruar nuk ka dekluar se ka ndonjë vlerë, përpos për ‘selamin’, të cilin e ka cilësuar si përshëndetje të ‘bekuar’ (mubaraketen) dhe të ‘këndshme’ (taj-jibeten) (En-Nur:61). A ka dëshmi më të madhe për muslimanin, për të vërtetuar epërsinë e një vlere kundrejtë të tjerave se sa dëshmia e Allahu i Madhëruar? Pa dyshim se nuk ka. Allahu i ka ditur dhe i dinë dhe do t’i dijë të gjithë përshëndetjet e karakterit njerëzor, por ‘selamin’ e ka bërë të jetë përshëndetja e Tij, jo vetëm për këtë botë, por edhe për banorët e xhennetit, që është edhe një dëshmi shtesë për mirësinë e ‘selamit’. Sepse gjithçka që i atribuohet xhennetit, vlera e saj është jashtë çdo krahasimi. Cila prej përshëndetjeve njerëzore i ka këto begati? Sigurisht se asnje.

2. ‘Selami’ është fjalë e Kur'anit dhe e Sunnit.

Më lartë kemi përmendur ajetet, të cilat citojnë tekstualisht se ‘es-selamu alejkum’ është pjesë e citateve kur'anore. Funksionalizimi i ‘selamit’, në raportet ndërshoqërore gjithësesi e ka këtë frymë, pra, atë të respektimit të një urdhëri dhe fjale të Kur'anit dhe Sunnit të Pejgamberit s.v.a.s., për dallim prej të gjitha përshëndetjeve tjera të llojit njerëzor, që nuk

e kanë synimin e tillë. Ndërsa është fare e qartë se citimi i një fjale të Kur'anit, në kuptim të funksionalizimit të urdhërit të Kur'anit dhe respektimit të tij, konsiderohet vepër e lavdëruar te Allahu i Madhëruar dhe e shpërblyer. Po kështu është edhe me aplikimin e një dispozite nga Hadithi i Pejgamberit s.a.v.s.. Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Kush e lexon një shkronjë nga Libri i Allahut, atij për këtë i takon një e mirë, ndërsa kjo e mira është me dhjetëfishin e saj....”¹

Sipas kësaj, përshëndetja ‘es-selamu alejkum’ si fjalë e gjuhës arabe i ka tetë shkronja (s,l,m – a,l,j,k,m), që nga dhjetë sevape japid shumën prej tetëdhjetë sevapeve, e kur kësaj ia shtojmë edhe sevapet që pasojnë nga respektimi i një norme kur'anore, përfundojmë se shpërblimi për dhënie-marrjen e ‘selamit’ është shumë i madh.

Në kuadër të kësaj, ‘selami’ si një sintagmë kur'anore, ka edhe një vlerë tjetër. Imam Ebu Hanife r.a. rreth ajeteve të Kur'anit thotë: “Të gjitha citatet (ajetet) e Kur'anit në kuptimin e tyre si fjalë (e Allahut) janë të barabartë si në vlerë (në kontekst të shprehjes) ashtu edhe në madhëri (në kontekst të domethënies). Përveç disa ajeteve të cilat përpos që e kanë vlerën e vet si fjalë e Allahut, ato e kanë edhe vlerën për shkak të karakteristikës së përbajtjes.”²

1. Sunenu Termidhij, “Kitabu fedailil Kur'ani”, babu: ma xhae timen kare'e harfen. Hadithi nr. 2835.


2. Ebu Hanife ‘El-Fikhul-Ekber’, sipas Orhan Bislimaj “Akaidi Hanefij” Prizren,

E ‘selami’, pa dyshim se i ka këto vlera, sepse përveç tjerash ai është edhe një prej emrave të Allahut e, emrat e Allahut, padallim, pa dyshim kanë domethënë të madhe.

3. ‘Selami’ është lutje për atë, të cilat i drejtohet ai.

Argumenti që e vërteton se ‘selami’ ka karakter të lutjes, është rregulli besimor se me këtë përshëndetje nuk lejohet që të përshëndeten jomuslimanët. Kjo sepse, ‘selami’ si domethënë, bartë një uratë të madhe dhe lutje që kon siston shpëtimin, sigurinë, paqën nga të këqiat etj., cilësi këto që, Allahu i ka bërë meritë për ata të cilët e besojnë Atë. Mbi këto parime, Allahu i ka ndaluar muslimanët që të lutën për jo muslimanët dhe, as mos t’i përshëndesin me ‘selam’. Kurorë e kësaj është praktika e Pejgamberit s.a.v.s., i cili përshkak të mos besimit të xhaxhait të tij Ebu Talibit, nuk kishte bërë lutje për të.

Le ta zëmë se edhe përshëndetjet e karakterit njerëzor kanë karakter të lutjes për atë, të cilat i drejtohet. P.sh. nëse i themi “mirëmëngjes”, me këtë bashkëbiseduesit po i urojmë një mëngjes të mirë. Ngjashmërisht është edhe me uratat tjera si: mirëditë, mirëmbërëma, tungjatjeta, mirupafshim, etj. Të gjitha këto, janë një lloj urate në vete. Mirëpo, cili është perimetri, që karakterin e ‘selamit’ si lutje ndaj besimtarit, e bënë të veçantë, nga karakteri



teri i përshëndetjeve tjera të llojut njerëzor?


Kësaj pyetje i përgjigjemi kështu: ‘selami’ si lutje është i pakrahasuar me asnje përshëndetje tjetër, sepse, kur muslimanin e përshëndesim me ‘selam’, atë e kemi uruar, apo për të jemi lutur me një domethënë shumë dimensionale që përfshinë: paqen, sigurinë, shpëtimin dhe të tjerat me radhë, dhe të gjitha këto domethënë që i inkorporon ‘selami’ i adresojmë te Ai, i cili ka mundësi që t’i plotësojë të gjitha këto të mira, e Ai është Allahu i Madhëruar. Pra, nëpërmjet ‘selamit’ bëjmë një lutje dhe këtë lutje në të njëjtën kohë e drejtovjmë te Allahu që t’i dhurojë shëndet, atij të cilin po e përshëndesim. Ky është qëllimi i ‘selamit’ dhe çdo vepër që e

bën besimtarit atë e drejton te Allahu, si Dhurues i vetëm i të gjitha të mirave, që njeriu i gëzon.

Për dallim prej përshëndetjeve tjera të karakterit njerëzor, të cilat përpos që kanë një domethënë shumë të lokalizuar, kanë karakter formal. Sepse, ta urosh dikend me përshëndetjen ‘mirëdita’ apo ‘mirëmbërëma’, kjo do të thotë që me këtë uratë, t’i shprehish një admirim personal, por pa e adresuar te Ai i Cili ka mundësi që këtë ‘mirëditë’ apo ‘mirëmbërëma’ ta shndërrojë në realitet.

Prandaj për këto arsyet dhe të tjera, përshëndetja ‘es-selamu alejkum’, është unikate dhe e pakrahasueshme me asnje përshëndetje të karakterit njerëzor.

Felajmësia (nubuvetu) dhe Fedërgueshmëria (risaletu) në dritën e Librit të Allahut



*“... Ne nuk dënojmë asnje popull, para se të
çojmë të dërguar!”*

(El-Isra' 17:15).



Besimi në Allahun xh. sh. është i vjetër sa edhe njeriu. Respektivisht, besimi është më i vjetër se njeriu, por vetëm me krijmin e njeriut dhe të krijesave të tjera besimi mori funksionin e udhëzimit hyjnor në rrafshin historik. Ai është i lidhur ngushtë me dy dukuri apo dy parime thelbsore dhe me një dukuri të tretë si harmonizuese e dy të parave:

1) Dukuria e padukshmes. Sikur Allahu i madhërishtëm të ishte i dukshëm, i prekshëm, i kapshëm, atëherë besimi do të

ishte i panevojshëm, pa kurrrfarrë kuptimi, sepse Allahu do të ishte një krijesë nga mesi ynë, një nga krijesat e kufizuara, të mundshme, në kohë e hapësirë.

2) Dukuria e sprovës, e sfidës. Tërë kjo krijesë komplekse (gjithësia), tërë ky empirizëm botëror konsiston në mënyrë që nëpërmjet besimit të sprovohet kundrejt Allahut, kundrejt krijesave të tjera dhe kundrejt vvetes. Konsistimi do të tregojë edhe se sa njeriu është i përkushtuar ndaj Allahut dhe nëse

ai e ka merituar shpëtimin dhe shpërblimin apo ndëshkimin dhe shkatërrimin, gjë që varet prej aktivitetit të tij mendor dhe praktik.

3) Dukuria e Shpalljes (vahj). Vrojtuesi i zgjuar do të vërejë se ndërmjet këtyre dy dukurive, të besimit dhe të sprovës, ekziston një kundërthënie, sepse besimi dhe sprova me të padukshmen dhe të panjohurën nuk mund të pajtohen mes tyre. Mirëpo, kjo kundërthënie që shihet në fe, në shikim të parë, pajtohet nëpërmjet **dukurisë së tretë**,


të shpalljes (vahj) nga Allahu i madhërishëm. Vetë shpallja nuk është krejtësisht e kapshme, e dukshme dhe nuk e obligon askënd të besojë, por, e shprehur me gjuhë më të thjeshtë, ajo është e pranishme, e udhëzon njeriun dhe e ndriçon zemrën dhe shpirtin e tijt, ashtu sikurse drita e Diellit ndriçon edhe pse vetë nuk mund ta shohim atë.

Duke ndjekur këtë rrjedhë vijmë deri te dukuria e **bartësve** të **misionit Allahut** të madhërishëm në Tokë, te dukuria e Felajmëruesit (nebijullah), te dukuria e të Dërguarit të Allahut (Resulullah). Ata i zgjedh Krijuesi ynë nga mesi ynë, nga populli ynë, nga gjuha jonë, përtatë përcjellur porosinë hyjnore besnikërisht dhe plotësisht. Të dërguar (rusul) dhe lajmërues (enbjaja') qenë bijtë e Ademit a.s., e jo krijesa të tjera, sepse sikur pejgamberët mos të ishin njerëz, do të mistifikohej feja dhe tërë misioni:

“... Ne nuk dënojmë asnjejë pull, para se të çojmë të dërguar!” (El-Isra' /17:15).

“(Këta janë) të dërguar që kanë sellë lajme të mira e kanë paralajmëruar, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së të dërguarve. Se, Allahu, është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm.” (En-Nisa' /4: 165).

Është e qartë se **nubuvveti** (felajmësia) dhe **risaleti** (fedërgueshmëria) nuk është e njëjtë gjë. Sipas asaj që njohim, **risaleti** është porosia, mesazhi hyjnor, i dërguar nëpërmjet një të dërguari (resul). Në këtë mesazh qëndron shpallja e Allahut, si udhëzim i gjithëpërfshirës përjetën njerëzore. Resulët pose-



doinë njëkohësisht edhe cilësinë e nebijëve (felajmëruesve). **Nubuvveti** (felajmësia) dallon nga risaleti, sepse në këtë rast misionari i Allahut nuk pranon shpallje (risale), por e vazhdon një shpallje të mëparshme të një resuli të mëhershëm. Në pajtim me këtë një *nebij* (felajmërues) nuk mund të jetë *resul*, sepse nuk ka pranuar shpallje të re, por ka vazhduar ta prezantonjë dhe punojë sipas misionit të mëhershëm. (M. Handzic, Izabranë djela, VI, Sarajevo, 1999, fq. 381).

Sipas kësaj rrjedhe mund të përfundojmë se të gjithë pejgamberët e Allahut (nebijë dhe resulë) nuk kanë të njëjtën gradë pejgamberike. Nga i gjithë numri që përmenden në Kur'an, disa dijetarë dallojnë pesë: Nuhi a.s., Ibrahimi a.s., Musai a.s., Isai a.s. dhe Muhammedi a.a., por disa dijetarë

të tjerë dallojnë shtatë më të dalluar: Ademi a.s., Nuhi a.s., Ibrahimi a.s., Musai a.s., Davudi a.s., Isai a.s. dhe Muhammedi a.s.. Përkundër këtyre dallimeve, të gjithë të dërguarit e Allahut gëzojnë te Allahu i madhërishëm status të veçantë, shumë më të veçantë krahasuar me krijesat e tjera, madje do të thoshim njëfarë statusi “të shenjtë”. Por, kjo shenjtëri nuk bën të kuptohet sikurse shenjtëria e disa personazheve në krishterizëm, por ata janë më të privilegjuar, më të ruajtur dhe me të drejtë ndërmjetësimi (shefaati) te Allahu xh. sh.. (Shih: Imam Ebu Hanifeh, Fikh’ul-ekber, Prizren, 2005, fq. 84). Ata kanë dashurinë, afërsinë, miqësinë, begatitë dhe dhuratat e veçanta, të cilat nuk mund t’i gëzojnë krijesat e tjera. Është e qartë se njeriu pejgamber nuk ka cilësi hyjnore, sepse ato janë privilegj ekskluziv i Allahut xh. sh.:

"Vetëm Ty të bëjmë ibadet dhe vetëm nga Ti kërkojmë ndihmë". (El-Fatihi, 5).

- Pejgamberët në Islam mbrohen. Ata kursehen nga vrazhdësia e përditësisë të besimtarëve të tyre. Ata janë njerëz në veprime, por mbrohet dinjiteti i tyre dhe i familjeve të tyre:

"O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos ju humbin veprat tuaja pa e ndier ju fare." (Kur'an, 49:2);

- Gratë e Muhammedit a.s. nuk mund të martohen me askënd:

"...Juve nuk ju lejohet që ta shqetësoni të Dërguarin e Allahut, as që të martoheni me gratë e tij pas (vdekjes së) tij. Kjo është vërtet gjynah i madh para Allahut." (33:53);



- Në çështjet shoqërore duhet të pranohet fjala e Muhammedit a.s.:

"Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar përkundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht.". (En-Nisa /4/: 65);

- Përkundër privilegjeve Pejgamberi a.s. plotësisht i përgjigjet Allahut xh. sh. dhe se as vetvetes nuk mund t'i ndihmojë pa lejen e Krijuesit:

"Thuaj (o Muhammed): "Unë i lutem vetëm Zotit tim dhe nuk i shoqëroj Atij askënd (në adhurim)". Thuaj: "Unë nuk mundem t'ju largoj ndonjë dëm e as t'ju sjell ndonjë dobi". Thuaj: "Edhe mua askush nuk mund të më mbrojë nga dënim i Allahut; dhe nuk mund të gjej strehim tjetërkund, përvëçse tek Ai. Unë kam për detyrë veç t'ju përcjell atë që më vjen nga Allahu dhe mesazhet e Tij. Këdo që s'dëgjon Allahun dhe të Dërguarin e Tij, e pret zjarri i Xhehenemit, në të cilin do të mbetet përgjithmonë." (El-Xhinn /72/: 20-23)."

- Të gjithë pejgamberët (nebijë e resulë) nuk mund ta konsiderojnë veten të barabartë me Krijuesin e tij. Kjo është e qartë sidomos te Muhammedi a.s.:

"Thuaj: "Unë jam vetëm një vdekatari si ju, që më është shpallur se Zoti juaj është një Zot i Vetëm....". (El-Kehf / 18/, 110).

- Por, edhe te Isai a.s. :

"O ihtarët e Librit! Mos e kaloni kufirin në besimin tuaj dhe për Allahun thoni vetëm të vërtetën! Mesihu - Isai, i biri i Merjemes, është vetëm i Dërguar i Allahut dhe Fjala e Tij, të cilën ia ka dërguar Merjemes, si dhe shpirt (i krijuar)

nga Ai. Pra, besojini. Allahut dhe të dërguarve të Tij! Dhe mos thoni: "Tre zota"! Hiqni dorë, se është më mirë për ju! Allahu është vetëm një Zot - qoftë lavdëruar Ai! Ai është tepër i lartësuar për të pasur fëmijë. E Tij është gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Allahu mjafton për rregullimin e gjithësisë. Mesihu nuk do ta përbuzte kurrë që të ishte rob i Allahut, as edhe engjëjt më të afërm. Ata që e shpërfillin dhe e nënçmojnë me arrogancë adhurimin ndaj Tij, Allahu do t'i sjellë të gjithë para Vetes." (En-Nisa /4/: 171,172);

- Edhe pse krijimi i Isait a.s. ishte ndryshe, ai nuk dallon nga të tjerët. U krijua me vullnetin e Allahut:

"Rasti i Isait për Allahun është si rasti i Ademit që e krijoi prej baltës e pastaj i tha: "Bëhu!" - dhe ai u bë." (Ali Imran /3/: 59).

- Njësia e Allahut ruhet me çdo kusht. Madje në disa ajete kjo çështje trajtohet në mënyrë dramatike, për ta përshkruar seriozitetin e problemit:

"Qiejt gati sa nuk copëtohen prej kësaj; Toka gati sa s'çahet e malet sa s'rrezohen të thërrmuar, ngaqë ata i veshin një bir të Gjithëmëshirshmit." (Merjem /19/: 90-91).

E qartë, felajmëruesh (nebijë) dhe të dërguarit (resulë) janë personalitetë të nderuara, shenjtërinë e të cilëve duhet respektuar, por në kuptimin Islam të monoteizmit të pastër (tevhid). Shenjtëria në Islam përkufizohet si dashuri e veçantë e Allahut e jo si pjesëmarrje në qenien e Tij, as si ndërmjetësues ndërmjet Zotit dhe krijesave, siç është rasti me krishterizmin.

Ne e kemi obligim që ndaj të gjithë të dërguarve të sillemi mirë dhe me respekt të plotë,

por dhe shenjtërinë e tyre duhet kuptuar drejt:

1. Të pranohet dhe dëshmohet vërtetësia e pejgamberisë së tyre dhe i librave, fletave që kanë sjellë;

2. Të lutet Allahu xh. sh. sa më shumë që t'i mëshirojë dhe t'i bekojë (të sjellë salavat);

3. Të duhen më shumë se çdo krijesë tjetër. Vetëm Allahu duhet më shumë se ata;

4. Fjalët dhe veprimet e tyre të pranohen si mënyrë e domosdoshme e të sjellurit dhe vepruarit tonë (sunnet).

Këto katër parime janë të domosdoshme t'i respektojmë te Muhammedi a.s., kurse te pejgamberët e tjerë vetëm tre pikat e para, sepse ardhja e pejgamberit të fundit i abrogon (shfuqizon) shpalljet e mëherësme dhe vlefshmérinë e tyre

praktike.

Edhe ardhja e Isait a.s. nga fundi i kësaj bote si shenjë paralajmëruese e Çastit të Fundit (jevmu's-sa'atu) do t'i dëshmohjë praktikisht këto katër parime, sepse ai do të veprojë sipas Kur'anit dhe Sunetit të Muhammedit a.s. e jo sipas pejgamberisë së tij.

Mirëpo, ka qenë dhe është vullnet i Allahut xh. sh. që njerëzit të kenë bindje të ndryshme në aspekt të lirisë së besimit. Imponimi nuk lejohet. Prezantuesi musliman më së shumti që mund të bëjë është prezantimi i besimit islam:

"Sikur të kishte dashur Zoti yt, të gjithë njerëzit do t'i bashkonte në një bashkësi të vetme, por ata vazhdojnë të jenë të përçarë, përveç atyre, që i ka mëshiruar Zoti yt. Për këtë qëllim Ai i krijoj ata. Do të plotësohet Fjala e Zotit tënd: "Me të vërtetë që do ta mbush Xhehemin me xhinde dhe njerëz bashkërisht!". (Hud /11/: 118,119);

"Ne kemi dërguar Tevratin, në të cilin janë udhëzimet dhe drita. Sipas tij, profetët që ia kishin dorëzuar veten Allahut, i gjykonin hebrejtë; por edhe të diturit dhe rabinët kështu vepronin, sepse atyre iu qe besuar mbrojtja e Librit të Allahut, për të cilin ata dëshmonin. Prandaj, mos kini frikë nga njerëzit, por kini frikë vetëm prej Meje! Dhe mos i ndërroni Fjalët e Miam me ndonjë vlerë të vogël! Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka shpallur Allahu, ai është mohues i vërtetë. Ne u caktuam atyre në Teurat:jeta me jetë, syri me sy, hunda me hundë, veshi me vesh, dhëmbi me dhëmb dhe plaga me plagë (të njëjtë me të). Por kushdo që fal shpagimin si lëmoshë, ka bërë një vepër që është shlyerje për gjynahet e veta. Kushdo që nuk gjykon sipas

asaj që ka zbritur Allahu, ai është shkelës i vërtetë. Pas atyre profetëve, Ne dërguam Isain, të birin e Merjemes, si vërtetues të Teuratit që kishte ardhur para tij. Dhe i dhamë atij Ungjillin, në të cilin ka udhëzim dhe dritë, si përm bushje të asaj që ishte shpallur para tij në Teurat dhe si udhërrëfim e këshillë për ata që i frikësohen Allahut. Le të gjykojnë ithtarët e Ungjillit ashtu siç ka shpallur Allahu në të. Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka shpallur Allahu, ai është keqbëres i vërtetë. Ne të kemi zbritur ty (o Muhammed) Librin me të vërtetën, si përm bushës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre. Prandaj gjykoji ata sipas asaj që të ka zbritur Allahu dhe mos ndiq dëshirat e tyre, duke u shmangur kështu nga e Vërteta që të është shpallur. Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj dhe një rrugë të qartë. Sikur të donte Allahu, do t'ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t'ju provojë në atë që ju ka dhënë, andaj bëni gara për punë të mira! Të gjithë do të ktheheni te Allahu e Ai do t'ju lajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshti." (El-Maideh /5/: 44-48).

Madje, edhe në rastet kur mosbesimtarët shkaktojnë dëme, detyrë e jona është të lutemi:

"O Allah!, Udhëzoje popullin tim, sepse ata nuk dinë."

Çështja e nubuvetit dhe risaletit e trajtuar më lartë nga pikëpamja e jashtme e ajeteve kur'anore është rast i mirë për analiza edhe më të thella. Kur'ani është thesar i pashtershëm, kështu që thirrja për eksplorim është e hapur për të gjithë studiuesit muslimanë në të gjitha kohët.



Këshilla ime për çdo musliman dhe muslimane

V
ëlla musliman,

Po të jap një këshillë, jo për diturinë a për gradën time, thjesht për të fituar prej teje një lutje të sinqertë, se mos All-lahu më fal gjynahin e më fshin gabimin. Me këtë dua gjithashtu që kur ta takoj All-lahun, ta kem kryer të drejtën që ke mbi mua; këshillën, edhe nëse nuk të kam takuar personalisht.

Kjo është këshilla ime e shkurtër, po e paraqes para duarve tua, me shpresën që të të bëjë dobi: Po të këshilloj me këshillën e All-lahut robëve të Tij: "Ne ju patëm sugjeruar atyre që iu pat dhënë libri para jush, e edhe juve që të keni frikë nga All-lahu"¹.

Vëlla musliman,

Devotshmëria është ruajtja nga çdo gjë e dëmshme, fetarisht dhe materialisht. Prej këtu, çdo gjë e dëmshme, gabim a rrëshqitje që feja islame ka ndaluar, të larguarit prej saj quhet devoutshmëri! Pra, devoutshmëria është të ruajturit nga çdo gjë që e bën All-lahun të zemërohet me ty. Ajo është çdo derë që të afron me Zotin tënd dhe e bën Atë të jetë i kënaqur me ty.

1. Kur'ani: 4:131.

Devotshmëria është nënshtimi para urdhërit të All-lahut në adhurime dhe largimi nga ndalesat e Tij në punët e këqija. Prandaj, bëhu i devoutshëm pasi nuk do të kesh mjerim pas saj.

Le të shoqërohet devoutshmëria jote me dashurinë a frikën e All-lahut. Nëse do të shoqërohet me dashuri, dije se i dashruari turpërohet nëse i dashuri e sheh në një gjëndje që atij nuk i pëlqen, e nëse shoqërohet me frikë, dije se i cilësuari me të frikësohet që Dëgjuesi, i Dituri, Vëzhguesi ta shohë në një gjëndje të ndryshme nga urdhëresa e Tij.

Dhe dëgjo këshillën e të dashurit tënd, Resulull-llahit (a.s), i cili thotë: "Të këshilloj të jesh i devoutshëm ndaj All-lahut në të fshehtë dhe haptas. Kur të gabosh, kthehu dhe bëj mirë! Mos kérko kurrë diçka prej dikujt! Mos e prek amanetin dhe mos gjyko në mes dy vetave!"², sikurse porosit: "Të këshilloj të jesh i devoutshëm ndaj All-lahut, pasi ajo është koka e çdo gjëje. Të këshilloj xhihadin, pasi është murgëria e Islamit. Të këshilloj ta përmendësh All-lahun dhe

ta lexosh Kuranin, pasi është shpirti yt në qiell, përkujtimi yt në tokë"³

Të këshilloj të kesh turp prej All-lahut, pasi turpi qëndron pranë besimit. Të kesh turp prej Tij do të thotë të bindesh dhe të ndjesh se All-lahu është me ty dhe të sheh, dëshmon punën tënde, të dëgjon fjalën, di qëllimin tënd dhe asgjë nuk është e fshehtë për Të! Ruaju që të vëzhgojë me dijen e Tij dhe të gjejë në gjynah, kështu do t'i shkaktosh vetes ndërprerjen nga lidhja e Tij, mbulimin nga frika e Tij, largimin nga mbiqyrja e Tij., nefsi do të të marrë, më pas, nga e keqja, elementi i së mirës në veten tënde do të vdesë, nuk do të ndjesh më pendim, nuk do të ndjesh më asgjë, që do të thotë vdekje e zemrës para All-lahut, Zoti na ruajt!

Në hadithin e tij (a.s) thuhet: "Turpërohuni prej All-lahut siç duhet, pasi Ai ka ndarë mes jush moralin, siç ka ndarë edhe rizkun!"⁴ Gjithashtu thotë: "Tupërohu prej All-lahut, siç turpërohesh nga njerëzit e mirë të fisit tënd"⁵, sikurse

3. Imam Ahmed i Musnedin e tij, 3:82 nga Ebu Said Khudriu (r.a).

4. Bukhariu në Tarikhun e tij nga Ibni Mes'udi (r.a).

5. Ibni Adijj nga Ebu Umame (r.a).

2. Imam Ahmed i Musnedin e tij, 5: 181 nga Ebu Dherri (r.a).

**"Të këshilloj të
jesh i devotshëm
ndaj All-llahut në
të fshehtë dhe
haptas. Kur të
gabosh, kthehu
dhe bëj mirë!..."**



thotë: "Kur All-llahu zemërohet me robin e Tij, ia merr turpin. E kur ia merr turpin nuk do ta gjesh veçse urryes dhe të urryer. I merr edhe amanetin. E kur ia merr edhe amanetin, i merr edhe mëshirën. E kur ia merr edhe mëshirën, i merr edhe Islamin. E kur ia merr edhe Islamin nuk do ta gjesh veçse një shejtan të dëbuar!"¹

Të këshilloj të jesh i moralshëm, pasi morali i mirë i shkrin gabimet, i shton të mirat dhe bën që në mesin e njërežve të kesh një pozitë të lartë vlerësimi dhe nderimi! Pastaj, morali i mirë është cilësia më e mirë që mund të ketë njeriu, ai është natyrë e të dërguarve të All-llahut, të cilët u dërguan për plotësimin e moralit të njërežve, për të arritur gradët e mirësise dhe të plotësisë relative. I dërguari i All-llahut (a.s) ka thënë: "Jam dërguar për të plotësuar moralin"², sikur se ka thënë: "Morali i mirë i shkrin gjynahet si uji akullin, sikurse morali i keq e prish

punën si uthulla mjaltin"³, sikurse ka treguar se: "All-llahu i reveloi Ibrahimit: "O miku Im, të jesh i moralshëm, qoftë edhe me femohuesit që të hysh në dyert e të ndershëmve, pasi e kam vendosur: Ai që është i moralshëm do ta kem në hijen e Arshit Tim, do të banojë në rrithinat e Hyjnisi Sime, do të jetë pranë Meje!"⁴

Të këshilloj të jesh bamirës ndaj prindërve të tu, edhe nëse të bëjnë padrejtësi, pasi ata të dy janë porosia e All-llahut për ty! Thotë All-llahu i Madhëruar: "Ne e urdhëruam njëriun t'u bëjë mirë prindërve të vet..."⁵ e në veçanti me nënën tënde, e cila ka gdhirë netë të tëra, ka errur ditët e saj, të ka mbajtur brenda saj, vështirësi pas vështirësie. Jepi asaj atë që i takon nga respekti, bindja dhe sakrifica për t'i shërbyer.

Kujdesu që të mos e ngresh zérin tënd mbi prindërit e tu! Mos të qendrosh i vrenjtur para tyre, mos të largohesh

prej tyre ndërsa flasin, mos u nervozo me ta kur të këshillojnë dhe të mësojnë, "dhe shtrije pranë tyre krahun përulës e respektues..."⁶, pasi ata të dy janë si dy miq pranë teje, që ta shtojnë thesarin e pasurisë tënde me lutjet e tyre. Ata të dy e lartësojnë gradën e fisnikërisë tënde me pëlqimin e tyre ndaj teje. Ata të mbulojnë nën hijen e mbarësisë me gjëzimin e tyre, të largojnë mjerimin dhe pesimizmin me lumturinë e tyre. Prandaj, sakrifikoi sa të mundesh në atë që bën, duro dhe mbajt qdo gjë prej tyre, "mos u thuaj atyre as "uf""⁷ asnjëherë, pasi ajo është shprehje e mjerimit të jetës!

Dhe dije me plot bindje se ashtu si vepron sot me prindërit, do të të kthehet llogaria e saj nesër nga fëmijët e tu, sepse "siç bën ta bëjnë dhe me peshoren që peshon, peshohesh"!

*Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip*

Muhamed Sytari

1. Bejhaku nga Abdull-llah ibn Amr ibnul-As (r.a). Shih: "Kenzul-ummal", 3: 128, nr. 5798.

2. Imam Ahmedi në Musnedin e tij, 2: 381, Bukhariu në Edeb, Hakimi dhe Bejhaku në Shuab nga Ebu Hurejra (r.a).

3. Tabaraniu në el-Kebir nga Ibni Abbasi (r.a).

4. Hakim Tirmidhiu dhe Tabaraniu në el-Eusat nga Ebu Hurejra (r.a).

5. Kur'an: 46:15.

6. Kur'an: 17:24.

7. Kur'an: 17:23.

Të jesh i kënaqur me çfarë je dhe çfarë ke!

Shpesh gjatë ditës na bien rëndom në vesh fjalë të tillë si; "Ua çfarë makine luksoze qenka ajo!" "Ua çfarë fustani i bukur!" "Ah sikur të jetojë në një vilë të tillë!" "Sikur të kisha para do bëja këtë dhe këtë...". Zemrat tonë janë mbushur me atë që ne shohim, shtëpi të bukura, makina luksoze, rroba moderne dhe kërkojmë të kemi sa më shumë para.

Çfarë po bëjmë vallë?! A ia vlen që këto gjëra të vogla të dorës së njeriut që konsumohen kaq shpejt (shtëpitë, makinat, rrobat etj vjetërohen) të krijuar me kriimin madhështor të Allahut?! Ngre pak sytë nga qielli. Ai është krijuar para shumë e shumë kohësh dhe çdo ditë që e sheh duket i njëjtë, i ri. Mirësitet që Allahu ka bërë për ne (krijesat) janë të panumërueshme, ashtu siç e thotë Fuqipoti në Librin e Tij:

"Sikur të mundoheshit t'i numëronit mirësitë e Zotit tuaj nuk do të mund t'i numëronit dot". "Atëherë pra, cilën nga mirësitë e Zotit tuaj po mohoni?!"

Por njeriu, si krijesë e pa-

ngopur që është vazhdon të ankohet dhe të mos kënaqet me atë çka Allahu i ka dhënë.

Profeti Muhammed (a.s.) ka thënë: "Birin e Ademit nuk e ngop asgjë tjetër veç dheut".

Një ditë, një person shkon tek një dijetar dhe i ankohet se ishte i varfër, se kishte shumë telashe dhe se nuk e donte më jetën e tij.

Dijetari i thotë:

- A do ti jepje sytë në këmbim të njëmijë derhemëve?

Ai u përgjigj:

- Sigurisht që jo!

- A do ti jepje duart dhe këmbët në këmbim të njëmijë derhemëve?

- Padyshim që jo!

- A do zgjidhje çmendenin në këmbim të njëmijë derhemëve?

Burri iu përgjigj se një gjë të tillë sđo e bënte kurrë.

Atëherë dijetari i tha:

- A nuk të vjen turp nga vetja? E pranon se Allahu ti

ka dhënë të gjitha këto dhrurata të çmuara, të cilat nuk i blen dot asnjëherë dhe vazhdon të ankohesh!

Sulejmani (a.s.) ka thënë: "Kujt i janë dhënë katër mirësi, i është dhënë mirësi e madhe:

1 - Frika ndaj Allahut në fshehtësi dhe në publik;

2 - Të kënaqurit në kamje dhe skamje

3 - Drejtësia kur je i zemëruar

4 - Falenderimi në mirësi dhe fatkeqësi.

A je ti prej atyre që e kanë frikë Allahun dhe u digjet zemra për Të?! A je falenderues i Allahut apo je i pakënaqur me caktimin e Tij?! Të jesh i kënaqur me atë çfarë je dhe me atë çfarë ke do të thotë që ke njohur ALLAHUN, Zotin e gjithësisë.

Një i urtë ka thënë: "Në këtë jetë gjendet një parajsë që kush nuk e shijon, nuk do ta shijojë as parajsën e botës tjetër. Ajo parajsë është njohja dhe dashuria për Zotin".

Le të marrim shembuj nga

jeta e sahabëve dhe e pasuesve të tyre se si ata ishin të kënaqur me Allahun dhe caktimin e Tij.

Një ditë, njëri prej sahabëve pa një djalosh që falej me përkushtim dhe përqëndrim dhe pasi mbaroi namazin e pyeti:

- I biri i kujt je?

- Unë jam jetim. I kam humbur prindërit- u përgjigj djaloshi

- A dëshiron që të bëhem kujdestari yt?- e pyeti sahabiu.

- A do më ushqesh nëse kam uri?- e pyet djaloshi.

- Patjetër!- i thotë sahabi.

- Po nëse më grisen rrobat, a do të më veshësh? – pyeti sérish djaloshi.

- Patjetër- përgjigjet sérish sahabi me vendosmëri.

- A do më ringallësh, nëse vdes?

Sahabi çuditet dhe i thotë se diçka të tillë s'mund ta bëjë dot asnjë njeri. Atëherë djaloshi i thotë:

- Lermë me Krijuesin tim, i cili më krijoj, ma dhuroi, ma merr jetën dhe më ringjall.

- Pasha Allahun"-, tha sahabiu - Kush mbëshfetet tek

Ai, kaq do ti mjaftojë.

Përse nuk e kthejmë kokën pas dhe të marrim mësimet nga e kaluara?!

Atau (rahimehullah)
shkruan:

Një ditë shkova në treg dhe dikush kishte dalë të shiste një skillave, për të cilën-thoshte se është e çmendur.

Unë - thotë Ataiu - e bleva atë për shtatë monedha ari dhe e çova në shtëpi. Gjatë natës, pasi kishte kaluar një pjesë e saj, ajo u ngrit, mori abdes dhe filloi të falej. Në namaz qau aq shumë, saqë unë mendova se do të vdiste nga të qarët e tepërt.

Pasi mbaroi namazin, fillojti lutej Allahut duke thënë; "O Zoti im! Pasha dashurini që Ti ke për mua". Unë e ndërpresa duke i thënë; "Pasha dashurinë që kam për TY". Por ajo u inatos nga kjo dhe më tha: "Pasha Allahun, po të mos ishte dashuria e Tij ndaj meje, nuk do të isha këtu para Tij, por në shtrat, si puna jote!"

Shiko se ku ka arritur dashuria e këtij personi, që edhe duke qenë skillave ishte e përmalluar për Zotin e saj.

Profeti (a.s.) ka thënë se një ndër shtatë grupet që dojenë nën hijen e Arshit të Allahut

do të jetë ai grup i cili i ka lotuar syri dhe e përkujton Allahun në vetmi dhe në publik.

Ajo ishte skillave dhe ishte e përmalluar për Krijuesin, po ne që ALLAHU na ka lënë të lirë, a e duam Zotin sa ajo muslimane?! Këtë pyetje duhet tia shtrojë gjithësecili vetes së tij.

Përse kemi rënë në këtë gjendje gjumi?! Përse epshet po na bëjnë përvete dhe po na çojnë në një humnerë nga ku vështirë se mund të dilet më?!

Përse preokupohemi kaq shumë për këtë botë kur e dijmë se na pret një botë shumë herë më e mirë?!

Allahu, që pa dalë nga barku i nënës, ia ka caktuar riskun çdo krijese deri në çastin e vdekjes. Atë që Ai ta ka caktuar, do të vijë qoftë edhe grimca më e vogël. ALLAHU nuk është i padrejtë me kriesat por kriesat janë të padrejta me Të. O bijtë e Ademit, vdekja po afron! Mos u bëj mosmirënjos, por falenderoje ALLAHUN për mirësitë që ti ka dhënë. Ji i kënaqur me caktimin e Tij dhe do të jesh më i pasuri dhe më i lumturi në të dyja botët.

Ajete

“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si ka qenë i urdhëruar edhe atyre para jush, për t’iu shmangur mëkateve.

Agjërimi zgjat disa ditë. Ndonjëri prej jush që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër, le ti agjerojë në ditë të tjera aq ditë sa ka prishur. Dhe ata (njerëz) që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të japë aq sa të ngopet një i varfër me ushqim gjatë ditës (për një ditë agjërimi një ditë ushqimi).

E kushdo që të bëjë ndojë të mirë më tepër, për të është më mirë.

Por, agjërimi juaj është më i dobishëm, në qoftë se e dini (do ta agjeronit).

Këto ditë janë, ditët e muajit të ramazanit, në të cilin ka zbritur Kurani, udhërrëfyes për njerëzit, përplot me argumente përrugën e drejtë dhe dallues i së mirës nga e keqja.

Pra, kushdo që nga ju gjendet në këtë muaj – le të agjerojë, ndërsa ai që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër (le të agjerojë aq ditë sa nuk i ka agjëruar),

- Perëndia ka bërë lehtësi për ju, e jo vështirësi e mundime, - për të plotësuar numrin e ditëve të agjërimit (në një kohë tjetër), dhe për këto (lehtësi) duhet të madhëroni Perëndinë, që u ka drejtuar në rrugë të drejtë e të bëheni falenderues ndaj Tij.”

(Bekare: 183-185)



Juve u lejohet që gjatë netëve të agjërimit t’i afroheni bashkëshorteve tuaja.

Ato janë petku i juaj, e ju jeni petku i tyne. Perëndia e di mirë se ju nuk mund të duroheni, e keni tradhëtuar veten, e Perëndia u ka pranuar pendimin tuaj dhe u ka falur gabimin.

Prandaj, u lejohet kontakti me bashkëshortet tuaja dhe tani kërkoni atë që ka caktuar Perëndia për ju.

Dhe hani e pini deri në mëngjes (deri në imsam) deri sa të dallohet peri i bardhë nga peri i zi, pastaj plotësoni agjërimin deri në muzg (deri në perëndim të diellit). Mos ju afrohuni atyre gjatë kohës, kur gjendeni në itikaf në xhami! Këta janë kufijt e Perëndisë; pra mos ju afrohuni atyre! Kështu, Perëndia u shpjegon njerëzve dispozitat e veta, që të ruhen e të mos bëjnë punë të ndaluara.

(Bekare: 187)



Hadithe

Transmetohet nga Ebu Hurejre se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Kush agjeron Ramazanin me bindje dhe kënaqësi, i falen gjynahet e bëra."

(Buhariu, Muslimi dhe Ebu Davudi)



Transmetohet nga Ebu Se'id el-Hudrij se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Kush e agjeron Ramazanin, i njeh rregullat e tij dhe mbrohet nga ajo që duhet të mbrohet, i falen gjynahet e bëra."

(Bejhaki dhe Ibn Hibban)



Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi a.s. ka thënë: "Çdo vepër e njeriut shtohet, e mira prej dhjetë deri në shtatëqind herë. Zoti i Madhëruar thotë: "Përveç agjérimit, sepse ai është për Mua dhe Unë e shpërblej, sepse njeriu në të braktis kënaqësinë dhe ushqimin për Mua. Për agjéruesin ka dy gjëzime: gjëzimi i parë është në iftar, kurse i dyti në takimin me Zotin e tij. Era e keqe nga goja e agjéruesit është më e mirë te Zoti se aroma e miskut."

(Buhariu dhe Muslimi)



Transmetohet nga Ibn Mes'ud el-Gaffari se Muhammedi a.s. ka thënë: "Sikur ta dinë njerëzit vlerën e Ramazanit, do të dëshironin të jetë i gjithë viti Ramazan."

(Ibn Huzejme)



Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi a.s. ka thënë: "Tre personave u pranohen lutjet: Agjéruesit deri në iftar, udhëheqësit (prijesit) të drejtë dhe të keqtrajtuarit. Atyre duaja u ngrihet lartë, i hapen dyert e qiellit dhe Zoti i thotë: Pasha fuqinë time, do të ndihmoj, qoftë edhe pas një kohe."

(Ahmedi dhe Tirmidhiu)



Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi a.s. ka thënë: "Agjérimi mbron nga morali i keq sepse ai që agjeron nuk flet gjëra të turpshme dhe nuk bërtet. Nëse (eventualisht) e shan ndokush ose e sulmon, le të thotë: 'Unë agjeroj, unë agjeroj'."

(Buhariu dhe Muslimi)



Transmetim nga Ebu Hurejre se Muhammedi a.s. ka thënë: "Zoti nuk ka nevojë që njeriu të braktisë ushqimin e pijen, por të mos braktisë fjalën e keqe dhe veprën e ligë."

(Buhariu)



Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi a.s. ka thënë: "Agjérimi nuk don të thotë të largohesh nga haja dhe pirja, por të largohesh nga fjala e keqe dhe vepra e shëmtuar. Nëse ndokush të provokon apo sillet si i marrë ndaj teje, atëherë thuaj: 'Unë agjeroj, unë agjeroj'."

(Tirmidhiu)



Transmetohet nga Zejd ibn Halid El-Xuheni se Muhammedi a.s. ka thënë: "Kush ushqen një agjérues, fiton shpërblimin e atij agjéruesi për agjérimin që ka bërë, pa ia pakësuar këtij të fundit shpërblimin e agjérimit".

(Ahmedi, Nesai, Ebu Davudi)





Rrisku apo furnizimi hyjnor

Një nga çështjet më kryesore që e shqetëson mendjen e njeriut është edhe "rrisku" që ndryshe mund të shprehet me termat tē tillë si: posedim, kismet dhe gjëra tē kësaj bote.

Rrisku përbën qendrën më të rëndësishme të programit të kaderit/fatit. Rrisku për njeriun fillon që me formimin e foshnjës në



barkun e nënës dhe vazhdon deri në ditën e gjykit. Exheli në këtë kuptim është pika e fundit që i përket njeriut në këtë jetë.

Rrisku është një dukuri e përcaktuar për të gjitha krijesat. Nuk shtohet dhe nuk pakësohet. Si rrjedhojë, rrisku i gjithë krijesave i përket Allahut. Në Kur'an thuhet:

"Nuk ka anjë gjallesë në tokë që All-lahu tē mos ia ketë garantuar furnizimin e saj" (Hud, 6)

Allahu i lartë çdo krijesë tē Tij e furnizon veç e veç. Prandaj miqtë e ngushtë tē Zotit i shpjegojnë zérat melodiozë tē bylbylave në degët e trëndafilave si një falënderim ndaj dhuntive hyjnore.

Një mik i ngushtë i Zotit nga ankthi i këtij furnizimi u thotë atyre:

- Rrisku i cilës prej krijesave fshihet në ambargët e siguruara? Ato krijesa asnjeherë nuk dëgjojnë një ankth rrisku.

Ka një ajet kuronor mjaft domethënës, i cili tregon se Allahu i Lartë u ka siguruar furnizimin tē plagosurve, tē pafuqishmve, duke përfshirë edhe ata që nuk kanë mundësi tē sigurojnë jetësën e tyre:

"Sa e sa gjallesa nuk kanë mundësi përfurnizimin e vet. Allahu i furnizon ato edhe



*“Nuk ka anjë gjallesë në tokë që All-llahutë mos ia ketë
garantuar furnizimin e saj”*

(Hud, 6)

juve. Ai është dëgjuesi, i dijshmi.” (Ankebut, 60)

Një tjetër çështje e rëndësishme që duhet të mësojmë lidhur me furnizimin e njeriut është edhe dallimi apo diferencimi në ndarjen e këtij furnizimi. Padyshim që më shumë se një dallim ky diferencim bëhet për të caktuar rregullin dhe drejtësinë mes njerëzve.

Në Kuran është përcaktuar qartë se thesari i çdo gjëje i përket Allahut dhe se çdo gjë bëhet në bazë të një programi të caktuar me të dhëna hyjnore. Besimtarët duhet të besojnë se këto situata të ndryshme materiale janë në të mirën e tyre. Sikur rregulli i kësaj jete të kishte mbetur në dorë të vullnetit të pafqishëm të njerëzve, në mbarë gjithësinë nuk do të ishte vënë re gjë tjetër veç anarkisë për shkak të dëshirave të njerëzv që nuk përpushten me njëra-tjetrën dhe të punëve që ndryshojnë çdo moment. Allahu thotë:

“A thua ata e përcaktojnë mëshirën (pej-gamberllékun) e Zotit tënd? Ne kemi përcaktuar ndër ta gjendjen e jetës në këtë botë; Ne kemi dalluar disa në shkallë më të lartë se të tjerët, që të shfrytëzojnë njëritjetrin për shërbime. E mëshira (caktimi për pejgamber) e Zotit tënd është shumë më e dobishme se ajo që ata grumbullojnë.” (ez-Zuhru, 32)

Ndarja e këtij rrisku apo furnizimi , e kompletuar me të fshehta, urtësi dhe forca të mbinatyrshme është një nga treguesit e fuqisë më madhore. Në çdo moment përgatiten sofa të ndryshme për të gjitha krijesat, qofshin ato që fluturojnë në ajër, qofshin ato që ecin në tokë apo edhe ato që notojnë në det. As njëri dhe as tjetri nuk mund të vazhdonë deri në përfjetësi. Pra ushqimet e këtyre krijesave janë të ndara dhe të përcaktuara sipas vendit ku ndodhen dhe fakti që kemi një ndarje të këtij furnizimi të gjallesave të panumërtë të gjithësisë është një tregues i madh i urtësisë, fuqisë dhe salltanitetit hyjnor në këtë gjithësi për të gjithë ata që mendojnë dhe gjykojnë.

Në Kuran thuhet:

“A nuk e dinë ata, se All-llahu i jep furnizim të plotë atij që do. Edhe në këto ekzistojnë fakte për një popull që beson.” (ez-Zumer, 52)

Nisur nga kjo e vërtetë i dërguari i Allahut thotë:

“Kur ndonjëri prej jush të shohë atë që është mbi të nga ana financiare dhe fizike, ta kthejë vështrimin e tij edhe tek ai që është poshtë tij. Një gjë e tillë ndihmon që mos të nënverësohet mirësia që jep Allahu.” (Bu-



hari, Rikak, 30; Muslim, Zuhd, 8; Tirmidhi, Kijamet, 59)

Prandaj ne jetojmë të qetë për sa kohë që besojmë se kjo ndarje e furnizimit të Zotit është në dobinë tonë. Ka shumë ngjarje që mund të shihen si një shkatërrim apo humbje për ne dhe në përfundim dalin një dhundi, si psh varfëria prapa së cilës qëndron xheneti. Por ka edhe situata të tilla që shfaqen si dhundi, por përfundimi i tyre është një humbje e dhembshur si psh: pasuritë që nuk jepen sadaka, por që mbahen vetëm për plotësimin e nevojave vetjake. Në Kuran thuhet:

“Hani nga të mirat që u dhuruam, e mos u bëni përbuzës se do t'u godasë hidhërimi Im, e atë që e zë hidhërimi Im, ai ka mbaruar.” (Taha, 81)

Nisur nga të gjitha këto të vërteta, në sajë të lumturisë së dy botëve, njerëzit janë shumë më afër Zotit përsa i përket furnizimit që jep Ai. Sipas të vërtetës që rrisku është i ndarë

dhe përcaktuar nga ana e Allahut dhe se është krijuar para krjimit të njeriut, vetë njerëzit duhet t'i dorëzohen Allahut në mënyrë që të shijojnë një furnizim të tillë dhe të arrijnë në besimin tek fati.

Në hadith thuhet:

“Allahu u tha melekëve të ngarkuar me detyrë në mbikqyrje të furnizimit të njeriut:

Nëse njërin prej robërve e shihni të përqëndruar tek Zoti garantojini atij furnizimin në tokë dhe në qiell! Nëse ndonjërin prej robërve e shihni duke kërkuar rriskun me drejtësi silluni mirë me të dhe lehtësojani rrugën!” (Hadith kudsi, Transmetim nga Ebu Hurejre)

Ky hadith tregon se nëse një rob i drejtohet vetëm një gjëje, i bindet urdhërit hyjnor për të fituar pëlqimin e Tij dhe bëhet i devotshëm në adhurimet e veta atij i sigurohet furnizimi në qiell dhe në tokë. Allahu i Lartë njerëzve të tillë u përgatit në një kohë të gjatë hapësi-

ré pér rriskun. Një e vërtetë e tillë shprehet edhe në ajetin Kuranor:

“...kush iu përbahet dispozitave të Allahut, atij Ai i hap rrugë.” (Talak, 2-3)

Në hadith thuhet:

“Sikur t’i bindeshit ashtu siç duhet Allahut edhe juve do t’u furnizonte me dhuntitë e veta siç i ka ngopur zogjtë. Zogjtë dalin në mëngjes të etur pér ushqim dhe kthehen në mbrëmje të ngopur.” (Tirmidhi, Zuhd, 33; Ibn Maxhe, Zuhd, 14)

Janë të rralla krijesat si milingona që mbledhin ushqime nga vera në dimër. Është një realitet që njihet nga të gjithë se krijesat e tjera nuk bëjnë përpjekje të tilla. Si është e mundur që Allahu i Lartë e lë pa mirësi krijesën e Vet brenda një sistemi të tillë kaq të rregullt?

Sjellje të tilla të ulta si dembelizmi, zilia, mosdëshira pér fëmijë etj. janë botëkuptime të gabuara dhe të shtrembërtë pér rriskun.

Siç u shprehëm edhe më sipër Islami i ka përcaktuar secilit rriskun e tij në këtë jetë dhe kjo nuk do të shtohet as pakësohet.

Allahu i Lartë çdo krije i ka njojur të drejtën pér të jetuar pér një kohë në këtë jetë duke i dhënë atij edhe furnizim nga dhuntitë e veta. Jeta e njeriut dhe çdo gjë që lidhet me të është përcaktuar në fatin e tij. Ademi (a.s) është koduar në trashëgiminë e tij. Pér të fituar rriskun tonë urdhërohemë të punojmë mbi bazën e ligjeve të arsyeve. Nga kjo del se puna duke iu bindur urdhërit hyjnor është një detyrë pér ne. Pra ky rrisk që është përcaktuar pér ne varet nga puna dhe përpjekja jonë.

Është e njojur kjo fjalë e urtë popullore: “Mos gabu në marrjen e masës, mos shpif në vlerësim!” Allahu i Lartë e ka pajisur robin e Tij me ligjet hyjnore si: “vullnet, përparësi, guxim, detyrim, përkrahje, provim, përgjegjësi”

Të dalësh kundër këtyre ligjeve është një

lloj proteste ndaj Zotit.

Mbrojtja nga rreziku është në natyrën e qenies njerëzore sikurse shkojmë tek doktori kur sëmuremi, kur marrim ilaçe, kur dalim menjëherë në rrugë në raste urgjence.

Përpjekjet e njerëzve pér të fituar rriskun janë një urdhër hyjnor pér t’u mbrojtur nga rreziqet. Kjo nuk është diçka në kundërshtim me programin e kaderit, përkundrazi është një respekt dhe një sjellje e duhur ndaj urdhërit hyjnor. Sikur të ishte e kundërtat atëherë nuk do të kishte kuptim dhe asnje urtësi urdhëri që na është dhënë. Mosbindja ndaj ligjeve të arsyses është një kryelartësi dhe gjynah.

Në Kuran thuhet:

“Njeriut nuk i takon tjetër pos asaj që ka punuar” (en-Nexhm, 39)

I dërguari i Allahut ka thënë:

“Është më e dobishme pér njeriun të marrë një litar, të ngjitet në mal, të marrë dru dhe të ulet dhe t’i shesë ato sesa t’i zgjasë dorën





*“Hani nga të mirat
që u dhuruam, e mos
u bëni përbuzës se do
t'u godasë hidhërimi
Im, e atë që e zë
hidhërimi Im, ai ka
mbaruar.”*

(Taha, 81)

të tjerëve pér lëmoshë, edhe sikur njërëzit ta japid atë që dëshirojnë, edhe sikur mos ta japid...” (Buhari, Zekat, 50)

Sipas shpjegimit të Ibn Firasit babai i tij e kishte pyetur të dërguarin e Allahut:

- O i dërguari i Allahut! A të kërkoj ndihmë prej dikujt tjetër? Dhe i dërguari i Allahut i është përgjigjur:

- Jo, mos e kërko! Nëse je i detyruar të kërko, këtë bëje nga njërëzit e devotshëm! (Davud, Zekat, 28)

Gjithashtu Allahu i Lartë ka krijuar mundësinë që krijesat të ndihmojnë njëri-tjetrin pér të siguruar rriskun dhe furnizimin e Allahut. Si rrjedhojë mbikqyrja e të varfërit, ndihmesa pér nevojat e tyre është një dhundi e madhe, një dhundi hyjnore pér t'u dhënë atyre nga ajo që Allahu na ka dhënë.

I dërguari i Allahut së bashku me Ebu Bekrin, Omerin, Osmanin dhe Aliun kanë radhitur tre gjëra që i bëjnë ata të lumtur në këtë jetë. Në këtë moment erdhi Xhebraili i

cili u bë pjesë e kësaj bisede. Pejgamberi (a.s) kërkoi që edhe ai të numëronte tre gjëra dhe Xhebraili iu përgjigj:

- Si të kisha qenë një prej njërëzve të kësaj bote do të kisha pëlqyer këto tre gjëra: të jem udhëzues pér ata që kanë humbur rrugën, të doja ata që kryejnë adhurimet edhe pse janë në varfëri dhe të ndihmoja të varfërit me shumë fëmijë.

Një tjetër çështje me shumë rëndësi është edhe kafshata hallall. Pasuria e vërtetë që ia zbardh faqen dhe e lartëson njeriun është kafshata hallall e fituar në rrugë të ligjshme.

Zgjedhja e hallallit tek rrisku është drita e jetës, rrezatim i shpirtit, rritje e anës shpirt-ërore të adhurimeve dhe tregues i një zemrë të pastër.

Furnizimet e marra haram janë helmet e jetës, zjarret dhe dëmet e zemrës. Vuajtjet, pasiguritë dhe fatkeqësitë në këtë botë dhe në ahiret janë rezultat i dhutive shkatërruese.

Malli dhe ushqimi hallall janë një nismë

për të fituar pëlqimin e Allahut. Pasuria dhe ushqimi që ka prekur haramin është një humbje e madhe për të zotin. Nëse pasuria dhe fëmijët pushtojnë zemrën në vend që t'i drejtohen Allahut, fundi është i trishtueshëm. Mevlana tregon:

- Uji në anije e fundos atë, ndërsa uji poshtë saj e ngre dhe i jep mundësi të vazhdojë rrugën.

Sulejmani (a.s) e hoqi nga shpirti i tij dashurinë për pasurinë dhe tha:

- Unë jam i varfër. Të varfërit i shkon të matet me të varfërit! Dhe u ngrit në shkallën më të lartë.

Allahu i Lartë thotë:

- O njerëz! Të gjithëjeni të varfër. I pasur është vetëm Allahut..." (Fatir, 15)

Prandaj edhe i dërguari i Allahut për ata që kanë pasuri vetëm për fe dhe Zot thotë:

- Sa mall i mirë është ky, sa me vlerë!

Omeri (r.a) bëri një dua të tillë:

- O Zoti im, Pjesën që tepron nga pasuria jonë lërua porosi atyre që punojnë për hajr. Shpresojmë që edhe ata t'ua jadin nevojtarëve.

Duke qenë se paraja haram i përket dikujt tjetër, ajo nuk ka as zeqat as sadaka. Ajo të nxin ftyrën si në këtë botë edhe në ahiret.

Kafshata hallall përcjell në trup urtësi, shkencë dhe qëllim të mirë dhe zgjon në shpirt dashurinë për Allahun.

Ashtu sikurse nuk mbaron elbi aty ku mbillët gruri dhe nuk mbaron misri aty ku mbillët elbi të njëjtat rezultate vihen re edhe në ushqimet materiale dhe shpirtërore që futen në trupin tonë. Nëse trupi nuk ushqehet me ushqime hallall që i jasin forcë shpirtit për të njojur Krijuesin nuk mund të arrihet bota shpirtërore në zemër dhe qetësia në adhurime.

Në një hadith thuhet:

"Unë i turpëroj ata që jasin llogari për çmbajnë periz nga harami"

Kjo do të thotë se është e domosdoshme që të sigurohet i gjithë ushqimi nga ajo që është hallall. Kjo pasi ajo që nuk do ta ndajë robin nga rruga e drejtë, që do ta zbukurojë atë me ndjenjat dhe urtësitë hyjnore dhe forca që do ta shkëpusë atë nga vuajtjet e kësaj bote duke e çuar në dritën e Allahut është vetëm tek ajo që është hallall.

Mevlana tërheq vëmendjen duke thënë se ushqimi i vërtetë që do ta formojë njeriun shpirtërisht dhe moralisht në sajë të ushqimit hallall është pikërisht ushqimi shpirtëror dhe moral dhe më pas vazhdon:

"Nuk ka ushqim tjetër për njeriun veç dritës. Shpirti nuk mund të ushqehet me diçka tjetër të jashtme!"

"Ndaloje veten dalngadalë nga ushqimet e kësaj bote! Pasi ato nuk janë ushqim për njeriun!"



"Aftësoje veten për të marrë ushqimin qieillor! Përgatitu për të ngrënë kafshatën e dritës!"

"Dëgjoje thirrjen e Kuranit: "Kërkoni furnizimin tuaj nga mirësitë e Allahut!" (el-Xuma, 10)"

"Ta dish që për sa kohë që trupi nuk ka uri nuk i drejtohet Krijuesit dhe nuk i përulet Atij. Ta sjellësh në rrugë të drejtë kur është i ngopur është njëloj si të punosh hekurin kur është i ftohtë."

"Nefsi i ngjan Faraonit i cili i përulet Musait në kohën e skamjes."

"Nëse u shpëton këtyre copëzave të rënda të furnizimit do të meritosh furnizimin e vlefshëm dhe të lehtë."

"Edhe sikur të hash me mijëra furnizime nga ato shpirtërore përsëri mbetesh i kthjetluar dhe i pastër."

"Ushqehu nga ushqimi i Allahut, nga ai ushqim shpirtëror i madh sa një det! Përsëri udhëton i qetë si anija në det."

"Stomaku natyral e çon njeriun drejt artificiales, ndërsa ai shpirtëror drejt bukurisë."

"Kafsha e ushqyer me elb bëhet kurban ndërsa kush ushqehet me dritën e Krijuesit është si një Kur'an i gjallë."

"Hiq dorë nga stomaku dhe drejtohu shpirtit që të të vijë shpëtimi nga Allahu."

"Dije që uria është mbretëresha e ilaçeve, pëlqeje urinë dhe përkrahe atë."

"Të gjitha sëmundjet shërohen me uri. Të gjitha ushqimet shijohen vetëm kur je i uritur!"

Shpenzimet e kësaj bote janë individuale. Është e domosdoshme t'i shhangemi shpërdorimit. Kjo pasi mundësitet dhe pasuria janë të dukshme dhe të përcaktuara. Janë porosi dhe të llogaritshme. Përdorimi i tyre në mënyrë të çrregullt sikurse rregulli kapitalist i sotëm fut në rrezik jetën e brezave që vijnë. Në mesin e qenieve të gjalla është vetëm njeriu syri i të cilit nuk ngopet lehtë. Kurse kafsha e egër që futet në kopenë e deleve ha vetëm sa për të shuar urinë që ka. Pasi është



ngopur nuk vazhdon të vrasë më duke thënë: "këtë e ha nesër!" në atë moment duket sikur bëhet mik me delet e mbetura në kope. Përkundrejt kësaj njeriu është një qenie e pakufishme. Kushti i parë për ta shpëtuar atë nga ky pasion i papërmbytshëm është mbrojtja nga shpërdorimi me besimin se furnizimi as nuk shtohet as nuk pakësohet. Në Kuran thuhet:

"Nuk ka asgjë thesaret e të cilës të mos jenë tonat! Ne atë e zbresim vetëm deri në një farë mase." (el-Hixhr, 21) Këtu shpjegohet se ndarja jetësore bëhet me një vullnet hyjnor dhe atij që e kuption këtë i mbylljet rruga e zilisë dhe e pangopësisë. Tregohet se ky furnizim është i ndarë në përcaktimin hyjnor. Nëse i radhisim njëra pas tjetrës punët dhe pasionet kjo dëshirë që shkon zinxhir quhet "tul-i emel" Këto zgjasin deri në varr. Fundi është një humbje. Këto janë punë artificiale që kalojnë si hije, perëndojnë si dielli dhe nuk njojin fund. Kur kjo situatë shihet me mëndjemprehtësi është një mal me dhimbje.

Gjynahet e nxijnë zemrën dhe e kthejnë atë në të shurdhët. Pra e pakësojnë funksionin e saj. Në këtë aspekt, një nga pikat më të veçanta të sëmundjeve të zemrës është edhe ushqimi haram. Fakti që duaja e një njeriu që ha nga ushqimi haram refuzohet për 40 ditë me radhë duke qenë se përpunimi i një ushqimi në trupin e njeriut plotësohet për 40 ditë, është shprehje e eficënsës së haramit në sëmundjet e zemrës. Prandaj të ushqyerit me ushqime haram është një helm shpirtëror që i kalon trupit dhe kështu është e pamundur të shijosh shijen dhe lezatin e adhurimit.

Duhet t'i kushtojmë kujdes jetës së kësaj bote. Duhet të mos t'i shmangemi fitesës së përjetshme.

Duhet të bëhem i udhëtar drejt të vërtetave dhe mirësive të tillë që të japim të përkohshmen dhe të marrim të përjetshmen, të lëmë devijimin dhe të zgjedhim rrugën e drejtë.

"O Zot! Na mundëso suksesin me ushqime të pastra dhe hallall dhe me punë të devotshme.! Amin!

Elementet e demokracisë në islam

Bota islame e shekullit XX karakterizohet me ringjalljen e islamit të politizuar dhe provokimeve që i provokon modernizimi. Raportet në mes këtyre dyjave i kanë detyruar mendimtarët islam që të mendojnë në definicionin e shtetit dhe të shoqërisë islamë në përgjithësi. Bashkë me provokimet që i sjell epoka moderne janë paraqitur edhe urrejtje në mes të simpatizuesve të modernizimit, të cilët paraqiten si reklamues të imperializmit perëndimore dhe si tradhtar të vlerave të veta islamë, dhe të atyre të cilët rreptësish i përbahen islamit tradicional të cilët paraqiten si anëtar të para modernizimit dhe kundër modernizimit.

Në kontekstin e debateve në mes të orientalistëve mbi rënien e civilizimit islam, Bernard Lewis pyet se ku është gabuar. Me shekuj islami ishte në krye të civilizimit dhe të arriturave shkencore njerëzore. Dhe në botëkuptimin e vet myslimanëve, islami ishte si sinonim i civilizimit. Por me paraqitjen e mësimeve të reja dhe arsimimit të ri dhe hulumtimit përliri politike në bashkësitet e tyre, bota përendimore përparoi me vrull në shkencë e në teknologji dhe në trashëgimin kulturore duke e lloje botën islamë dukshëm pas vëtit. U paraqitën shumë teori te cilat i sqarojnë

shkaqet e këtij stagnimi e deri diku edhe të prapambeturise, e më e fundit ka të bëjë edhe me hulumtimin e vet islamit dhe themeleve në të cilat është ngritur shoqëria islamë. Nëse islamë është si pengesë e lirive, shkencës dhe zhvillimit ekonomik, atëherë si është e mundur që shoqëritë myslimanë në të kaluarën ishin si ato botërore në këto segmente, e kjo në atë kohë kur myslimanët ishin më afër burimit dhe inspirimit të fesë së tyre se sa që janë sot? shtrohet pyetja çka iu bëri islami myslimanëve? E pastaj tjetra: Se çka i bënë myslimanët islamit? Disa mendimtarë bashkë kohor islam konsiderojnë se faji bie mbi mendimtar, doktrina dhe grupe nga historia islamë të cilët i kishin përvetësuar qëndrimet dhe adetet e gabuara, derisa reformatorët dhe modernistët kanë qëndrim të kundërt dhe shkakun e shohin në qëndrimin e traditave të vjetra dhe në jo fleksibilitetin e dijetarëve islam.

Prapse prapë qasja më e mirë në këtë diskurs modern nuk është debati mbi islamin në tërsë, por mbi konceptin shoqëror dhe politik të islamit. Siç duket dilema kryesore e cila paraqitet në pyetjes së kompatibilitetit islam dhe të demokratizimit është ajo se, me zgjedhje vendoset pushteti autoritar i

cili nuk brengoset shumë mbi të drejtat e qytetarëve të cilët rezultojnë me konflikte në mes të grupeve të ndryshme. Siç duket mungesa e lirisë intelektuale, indokrinimi, mungesa e ekonomisë, menaxhimi i keçë i ekonomisë, mungesa e lirisë së qytetarëve nga tirania e solli në stagnim botën islamë. Sot më shumë se 120 shtete e zgjedhin pushtetin e vet me zgjedhje të lira. Për shumicën e botës demokracia është burimi i vetëm i legjitimitetit politik. Me fjalët e mendimtarëve modern islam paraqet edhe fenë edhe shtetin, a shteti islam nuk i plotëson të gjitha standartet të cilat i ofron demokracia moderne përendimore. Në anën tjetër nxitja e cila ekziston nuk është ajo në të cilën ata thirren, duke marr parasysh principet në të cilat themelohet shteti islam nuk janë kompatibile me konceptin e demokracisë përendimore.

Pra teza fillestare përkëtë debat është hulumtimi i konceptuar i burimeve ideologjike të kuptimit të shteti bashkëkohor islam. Është në pike pyetje se a mundën principet në të cilat themelohet shteti islam të bazarohen me nevojën e parametrave të perëndimit për demokraci. Është e domosdoshme të hulumtohen burimet islamë dhe konceptet e shoqërisë, mekanizmat që e vënë në lëvizje

të drejtën e shtetit, ndarjen e pushtetit, mbrojtjen e autonominë individuale, mbrojtjen i dinjitetit dhe pronësisë nga çdo lloj sulmi para se të thellohemë në debatin mbi elementet e demokracisë në islam. Për t'i hulumtuar çështjet e parashtuara më lart së pari duhet të hulumtojmë qëndrimet bashkëkohore mbi principet e shtetit islam. Pastaj duhet të bëjmë një vështrim të sqarimeve mbi elementet e demokracisë në islam. Në pjesën kryesore do ti analizojmë idetë themelore dhe qëndrimet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me këto çështje. E në fund do ta parashtrojmë edhe mendimin tonë.

Ideja e shtetit islam

Me paraqitjen e nacionaliteteve të lira islame pas ekspansionit të gjatë perëndimor dhe imperializmit në shoqërinë myslimanë paraqitet nevoja për ridefinimin e principeve udhëheqëse. Mendimtarët e ndryshëm modern islam e dhanë kontributin e vet në këtë diskutim duke filluar prej Xhemajl Eldin Avganiut, Muhamed Abduhu dhe Reshid Rida deri te Muhamed As'hadi, Abdullah Alamef Dudia, Reshid Ganuqi deri tek Tarik Ramadani. Shoqëria klasike myslimanë e cila u paraqit në shekujt që pasuan pas vdekjes së Pejamberit a.s e solli deri në kontekst në të cilin definohet jurisprudanca islame si themel juridik i shtetit islam. Kjo trashëgimi e madhe e kësaj tradite dhe jurisprudence islame ka mundësuar edhe themelimin për zhvillimin e konceptit të të privilegjuarve të rendit të parë mbi sunduesin dhe shtetin.

Zhvillimi i mendimit politikë në islam

Gjatë shekullit të XX-të dhe



shekullit XXI definohen nga fillimi principet e larte përmendura themelore. Disa dijetar fokusohen vetëm në Kur'an dhe synet, ndërsa shumica edhe ma tutje shfrytëzon juridiksionin e shariatit të cilin e kishin definuar dijetarët mes jetar. Nuk janë themeluar të gjitha urdhëresat juridike në islam në jurisprudencën islame fik-h të bazuara në udhëzimet Kur'anore ose në traditën e Muhamedit a.s. pjesa e madhe e kësaj tradite është udhëzuar në përdorimin e metodave deduktive të bazuara në analogji (kijas). Këto metoda deduktive shpesh herë kanë rezultuar në rezultate subjektive, kryesisht në ndikimin e shoqërisë dhe të rrëthanave intelektuale të asaj kohe. Qëllimi kryesor i shariatit ishte definomi i jetës njerëzore duke e përforuar me burimet (marufat) edhe me evitimin e

profanëve (munkarat). Për ti arrit këto ide me rrugë të korizës juridike juristët mysliman kanë themeluar bazat e kushtetutës, rregullimit shoqëror dhe penal.

Mendimtarët modern nisën të kërkojnë komentime të reja nga këto rregulla të vjetra juridike. Muhamed As'Hadi thotë se rregullat juridike të mesjetës janë marrë si pjesë përbërëse e jetës islame të cilat janë bërë si pengesë e përshtatjes së modernizimit. Mundësi e ekzistencës së sintezës moderne paraqet një ndër pikat konfrontimeve në mes të mendimtarëve konservativ, të cilët janë të mendimit se pushteti legjitim e vetëm islam është prapë kthimi i kalifatit, kurse në anën tjeter dijetarët progresiv, të cilët konsiderojnë se teoria politike nuk guxon të bazohet në komenti-

met historike por në zbatimet e më hershme të principeve bazë Kur'anore dhe traditës. Dijetari klasik El Shihristani në librin e tij El Milal ve Mihal thotë: e din me siguri se situatat e ndryshme nuk mund të numërohen ose të kufizohen, gjithashtu e din se teksti i shpallur nuk e definon në detaje ose me referencë direket të gjitha ngjarjet nga koha e shpalljes e këndej. Në secilin vend teksti është i kufizuar e ngjarjet jo, pra ngjarjet nuk duhet të kontrollohen me atë që është e kufizuar. Praktikumin e ixhihadit definitivisht duhet t'ia përshtatim kërkesave të nevojave. Dijetarët bashkëkohor pajtohen në atë se urdhëresat të cilat janë vlerësuara si të vërtetuara (bas) ose traditës së Muhamedit a.s edhe më tutje mbesin të tillë.

As 'Hadi e pranon sistematizimin e të drejtës juridike të Ibn Hazmit ndaj obligimeve juridi-

ke (farz), të cilat nëse lehen pas dore çojnë kah gjynahu, ose me përvetësimin e veprave të këqija, të cilat çojnë kah mëkatë (haram) dhe të punëve të cilat nëse lehen pas dore nuk çojnë kah gjynahu (mubah). Mubahi ndahet në të rekomanduara (mendub) dhe të padëshiruara (mekruh) dhe të padefinuara (mutlak). As Hadi pohon se çdo gjë që nuk është definuar në mënyrë të pa kundërshtueshme ose në mënyrë të vërtetuar i takon kategorisë mubah dhe meriton studim dhe sqarim bashkëkohor. Dike cituar hadithin e pejgamberit a.s "Mos pyetni për atë që është lënë e pa definuar, sepse ata që ishin para jush u mallkuan për shakë se iu parashtruan (pejgambereve të tyre) shumë pyetje kështu që hyri ndarja në mes tyre. Nëse iu urdhëroj të punoni diçka, dëgjoni dhe punoni nëse kjo është në mundësit tuaja, a nëse ua ndaloj diçka, atëherë largohuni nga ajo" /Muslimi. Me çka

As Hadi përfundon " Siç kemi pa, sheriati me qëllim përbahet nga dhënia e urdhëresave detale për të gjitha veprat juridike duke i ndërruar kërkesat e ekzistencës shoqërore. Nga kjo del nevoja për ligjin bashkëkohor dhe në kontinuitet. Në shtetin islam një ligj i këtillë do ti zgjidhte shumë rregulla e probleme të cilat sheriati nuk i definon, si dhe problemet për të cilat sheriati jep principet e përgjithshme e jo rregulla të detajuara. Në secilën prej këtyre situatave bashkësia duhet që ti zhvillojë detajet relevante dhe urdhëresat nëpërmjet të komentimit të pa varur (ixhihadit) e në pajtim me shpirtin e të drejtës islame dhe të dobive më të mira për popujt.

Mevdudiu këtë pjesë të së drejtës islame e cila u nënshtronhet ndërrimeve në pajtim me nevojat dhe kërkesat ndryshimeve të kohërave e ndan në: a) komentime të cilat përbëhen prej shtrirjes së rëndësisë së urdhëresës që gjendet në Kur'an dhe praktikës së Muhamedit a.s. b) analogjinë, c) komentimin e pavarur të juristëve, d) preferencat juridike të cilat i rregullojnë rregullat në pajtim me praktiken islame dhe sistemin juridik.

Sistemi politik i bazuar në sheriatin i cili nuk është i bazuar në të drejtën specifike ose dokument, e arrin kulminacionin e vet në institucionet juridike dhe metodat e katër kalifëve të parë. Në këtë kohë gjemë urdhëresa juridike të rëndësishme të bazuara në principet kuranore ose në praktikën e pejgamberit Muhamedit a.s., shembulli kryesor është se kalifi i dytë drejt Omeri ka themeluar trezorin shtetëror. Leja e Pejgamberit përfundon



min e komentimit të pa varur eshtë theksuar në bisedën e tij me Muadh Ibn Xhebelin para se të emërohet si sundues i Jemenit: "Në cilën mënyrë do tu dalësh në krye problemeve", pyeti Pejgamberi a.s, Muadhi iu përgjigj: "Unë do të veprojgjkoj me librin e Zotit". "E çka nëse aty nuk gjen udhëzim" ka pyetur pejgamberi Muhamed, Muadhi u përgjigji "atëherë do të gjykoj me traditën e Muhamedit a.s.". E nëse edhe aty nuk gjen udhëzime pyeti Muhamed a.s. atëherë pa hamendje do të gjykoj në pajtim me logjikën time. Pra asnjëra prej burimeve juridike të Muadhit nuk ishte e përhershme. Shembulli më bindës eshtë edhe veprimi për tu zgjedhur trashëgimtari i Muhamedit a.s, ose zgjedhja e katër kalifëve të parë. Deri sa Ebu Bekrin e zgjodhi shumica e emigrantëve dhe myslimanëve lokal në Medine ensarët, zëvendësin e tij hazdreti Omerin e zgjodhi vet Ebu Bekri, ndërsa hazdreti Omeri prapë e emëroi trupin zgjedhor prej 16 shokëve më eminent të Muhamedit a.s të cilët e zgjodhën kalifin e tretë hazdreti Osmanin, ndërsa kalifi i katërt Aliu, eshtë zgjedhur me votimin e shumicës së shqërisë myslimanë të asaj kohe. Mevdudiu rezimon sistemin politik islam në tri principe: njësia e Zotit tëvhid, pejgamberllëku i Muhamedit a.s risalat dhe sunduesin, kalifët.

Principet kryesore të shtetit islam

As hadi sqaron se qëllimi i shtetit islam eshtë që të sigurojë kornizën politike për unitetin islam dhe bashkëpunimin i cili bazohet në ajetin vijues të Kurabit "Dhe kapuni që të gjithë ju përlitarin (fenë dhe Kur'anin) e

Allahut e mos u përcani! Përkujtoni nimetin e Allahut ndaj jush kur ju (pra se ta pranonit fenë islam) ishit të armiqësuar e Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij arritet të jeni vëllezër. Madje ishit në buzë të greminës së xhehenemit e Ai ju shpëtoi prej tij. Po kështu Allahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju të gjeni të vërtetën e lumtur". (Kuran 3 103) Kuran-i parashtron edhe udhëzimet vijuese për definimin e rolit të shtetit , (Ai ndihmon) "Ata të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë e falin namazin jadin zeqatën, urdhërojnë për të mirë dhe largojnë prej të keqes..." (Kuran 22 41). Allahu më tutje definon edhe idealet e popujve mysliman duke i përshtuar si popullin më të mirë nga të gjithë të tjerët sa ishin, i cili popull kërkon që të bëhen vepra të mira dhe largohen nga të këqijat dhe beson në Allahun "Ju jeni populli më i dobishëm i ardhur për të mirën e njerëzve të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni Allahun..." (Kuran 3 110)

Mevdudiu si principe udhëheqëse të shtetit islam përmend adhurimin në një Zot dhe dëgjueshmërinë në të gjitha fushat e jetës, duke respektuar të drejtën e prindërve dhe njerëzit e rrezikuar, duke nda fitimin, duke e formuar politikën në bazë të diturisë të bazuar dhe duke e larguar nënçmin arrogancën dhe tiranin. Në anën tjetër duke i ngashënjye besimtarët si zëvendës të Zotit në tokë të cilët i zbatojnë ligjet e Tij, e përfaqësojnë realizimin e fesë në bashkësi njerëzore. Përtu lehtësuar aplikimi më i lehtë i ligjit islam, bashkësia e besimtarëve pa tjetër duhet të themeloj shtetin pushteti i të cilit do të

jetë përgjegjës ndaj tyre.

Legjimititeti i shtetit islam gjithashtu edhe mbështet në urdhëresat kuranore "O ju që besuat, binduni Allahut respekttoni të dërguarin dhe përgjegjësit nga ju..." (Kuran 4 59) As Hadi dhe Mevdudiu vijnë në përfundim se shteti islam nuk guxojnë ta injoroj përbajtjen e të drejtës islamë gjatë definitët të kornizës shtetërore. Edhe një princip tjetër i rëndësishëm eshtë respektimi i pushtetit të zgjedhur nga populli, deri sa këta i nënshtrohen Zotit dhe pejgamberit dhe falin namazin. Në shumë raste eshtë keqpërdor hadithi i Pejgamberit a.s : "Myslimanët janë të obliguar që ti pasojnë dhe ti nënshtrohen, pa marr parasysh iu pëlqen apo nuk iu pëlqen, deri sa të mos iu urdhërohet gjynahu., atëherë refuzohet dëgjueshmëria dhe nënshtrimi duke theksuar nevojën e dëgjueshmërisë qytetare". Buhari dhe Muslimi

Numri më i madh i mendimtarëve bashkëkohor vijnë në përfundim se sovraniteti absolut i takon popullit dhe koncentruar tjetës, duke i përmend adhurimin në një Zot dhe dëgjueshmërinë në të gjitha fushat e jetës, duke respektuar të drejtën e prindërve dhe njerëzit e rrezikuar, duke nda fitimin, duke e formuar politikën në bazë të diturisë të bazuar dhe duke e larguar nënçmin arrogancën dhe tiranin. Në anën tjetër duke i ngashënjye besimtarët si zëvendës të Zotit në tokë të cilët i zbatojnë ligjet e Tij, e përfaqësojnë realizimin e fesë në bashkësi njerëzore. Përtu lehtësuar aplikimi më i lehtë i ligjit islam, bashkësia e besimtarëve pa tjetër duhet të themeloj shtetin pushteti i të cilit do të

Marrëdhëniet interreligjioze në shoqërinë multireligjioze



"O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni mes vete,..."

(Kur'an 49:13).



Në këtë artikull ekspozohet qasja sociologjike ndaj marrëdhënieve interreligjioze në shoqërinë multireligjioze. Imperializmi konfesional është i zëvendësuar me pluralizmin konceptual. Ai kërkon, në vend të uniformimit, dallueshmëri legjitime. Ai do të kontribuojë në paraqitjen reale të traditës së tjetrit brenda bashkësisë "sonë" konfesionale.

Modelet sociologjike të marrëdhënieve mes religjioneve dhe mes konfesioneve,

në tekstu do të reduktohen në tri modele: a) ekskluzivizëm, b) inkluzivizëm dhe c) pluralizëm. Demonstrohet edhe një element tjeter sociologjik i rëndësishëm për bashkëjetësë dhe tolerancë. Në shoqëritë etnikisht dhe konfesionalisht heterogjene, çështja e tolerancës etnike dhe konfessionale është shumë domethënëse. Të jesh tolerant ndaj kulturave të tjera...d.m.th.të jesh i qytetëruar.

Për një bashkëjetësë me rëndësi është qëndrimi

ndaj tjetrit dhe asaj që është ndryshe. Duhet të dihet si të udhëhiqet dialogu, duhet bashkëpunim dhe duhet të mësojmë nga ata që janë ndryshe. Dialogu është jash-tëzakonisht vlerë kuptimponte në vigjilen e shek. XXI. Ne angazhohemi për qëndrim dialogues ndaj religjioneve tjera dhe për pluralizëm, që respekton integritetin e traditave të ndyshme religjioze (pa të cilën nuk ka as stabilitet).

Të pakta janë ato shtete ku

nuk ekzistojnë konfesione dhe religjione të ndryshme. Shumë faktorë shoqërore kanë ndikuar në të: prej shkaqeve historike e deri te migrimet moderne, si dhe proceset e ndryshme politike dhe ekonomike në botë. Ajo ua ka tërhequr vëmendjen edhe sociologëve (sidomos sociologëve të religionit), të cilët hulumtojnë ndikimin e përkatësisë në konfesione dhe religjione të ndryshme në marrëdhëniet shoqërore. Edhe në këtë tekost të shkurtër, fjala është për këndvështrimin e një sociologu ndaj marrëdhënieve interreligioze në shoqërinë multireligioze. Ajo ka edhe përparësitë edhe dobësitet e saj. Sociologu në Basnjë e Hercegovinë, në prezentimin e kësaj problematike, do të ballafaqohet me më së paku katër tipa "multi": a) multireligjioziteti, b) multikonfesionaliteti, c) multikulturaliteti dhe ç) multinacionaliteti. Sigurisht, është shumë vështirë që në mënyrë strikte të ndahen këto tipa, pasi multireligjioziteti shpesh ka kuptimin edhe të multikulturalitetit, në kushtet tona edhe të multinacionalitetit. Pra, kjo nuk është cilësi dalluese vetëm e shoqërisë boshnjako-hercegovase. Mund të thuhet se, qarqet e "përziera" religjioze, konfesionale dhe religjioze, nuk janë vetëm ardhmëri, por ato janë një realitet i botës bashkëkohore në përgjithësi. Nuk duhet lënë pas dore edhe papajtueshmëria mes sociologëve për përcaktimin e termave



çdonjërin me tipin "multi". Për shembull, Dr. Josip Zupanov, pohon se multikulturalizmi vjen prej nacionalizmit shtetëror, në të cilin bashkësitetë etnike veprojnë si të kulturuara, e jo si një identitet etnonacional. Sipas tij, presioni që prej bashkësive etnonacionale të krijohen bashkësi multikulturaliste, mund të jetë kundërproduktive. Tash e lëmë anash këtë mospajtim.

Multireligjioziteti dhe multikonfesionaliteti në shoqërinë boshnjako-hercegovase, gjithmonë ka çuar, dhe çon, drejt një bashkëjetese si dicëka që fillon me zhvillimin e natyrës ("O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni

mes vete,...", Kur'an 49/13).

Ka kaluar koha e imperializmit religjioz dhe konfesional. Ajo është ndërruar me kohën e pluralizmit religjioz dhe konfesional. Pluralizmi nënkuption shoqërinë e cila vepron nëpërmjet një sërë grupesh të ndryshme, që i japin asaj karakteristikë multikonfesionale. "Religjione" dhe "konfesione" janë shndërruar në "religion" dhe në "konfesion", sisteme të vetme religjioze dhe konfesionale në pluralizëm. E lexojmë Dhiatën e Vjetër apo të Re, ose Kur'anin, do të vërejmë se edhe ato shkrime të shenjta dëshmojnë për pluralizmin religjioz. Ato atë e kanë vërejtur nga pikëpamja e rrethit historik në të cilën kanë lindur, ashtu sikur

edhe ne sot që duhet shikuar pluralizmin (religjioz, konfesional dhe politik) në bazë të rrethanave të sotme historike. Një është e vërtetë se, ka kaluar koha e "përjashtimit" të shikimeve të ndryshme dhe të kulturave të tjera. Në marrëdhëniet ndërreligjioze dhe ndërkonfesionale nuk mund të ekzistojë uniformiteti, por dallueshmëria legjitime. Mbrojtësit e "pluralizmit teologjik", me të drejtë, paralajmërojnë se kanë ekzistuar, dhe se do të ekzistojnë në këto hapësira, dallimet dhe mospajtimet. Por, është më se e sigurt se: pluralizmi nuk duron ngarkim, mbivotim as në traditën konfesionale e as në atë politike. Një periudhë të gjatë shoqëria, sidomos ajo boshnjako-hercegovase, përbën bashkësinë e llojlojshme etnike, religjioze dhe

konfesionale. Dallimet etnike, gjuhësore dhe kulturore mund të manifestohen edhe në marrëdhëniet ndërreligjioze. A duhet, vallë, rikujtuar periudhën e luftës 1991-1995? Është treguar se në bashkësi të tilla nuk është që pikëpamjet religjioze të janë në "majën më të lartë", e as shoqërisht të margjinalizuara. Posaçërisht, është me rëndësi paraqitja e drejtë e traditës (etnike, religjioze, kulturore) të tjetrit brenda bashkësisë "tonë" konfesionale. Nuk mundet që vetëm e "jona" të diktojë marrëdhënie ndërkonfessionale. Është e nevojshme që në atë "paraqitje" maksimalisht t'i iket zvogëlimit dhe nënçmimit të traditës kulturore dhe religjioze të tjetrit. Për të duhet patur kujdes ata të cilët, për shembull, përpilojnë pro-

grame për mësim besimin në shkollat civile ose shkruajnë libra shkollar për atë qëllim. Përgjegjësia, sigurisht, që bie edhe mbi ata që i miratojnë ato programe dhe ato libra shkollar.

Në atë mënyrë mund t'i ikim integralizmit religjioz. Me fjalë tjera, modeli i integralizmit religjioz paraqitet sidomos në situata të prezenccës së "frikës" së dominimit të ihtarëve të grupit "tjetër" religjioz ose konfesional, respektivisht në dëshirën për mbrojtjen e përkatësisë së vet religjioze dhe konfesionale, për të cilën supozohet se është në rrezik. Integralizmi komunikimin maksimalisht e kohëzon drejt të qenurit anëtar i grupit të njëjtë religjioz/konfesional, kurse ekskluziviteti, kryesisht, qartësohet në lidhje me marrëdhëniet ndaj përfaqësuesve të grupit tjetër religjioz. Jotoleranca dogmatike shndërrohet në jotolernacë individuale në mes të besimtarëve.

Modelet sociologjike të marrëdhënieve mes religjioneve dhe konfesioneve mundet të paraqiten së paku në tre forma:

- Ekskluzivizmi:* sociologjikisht vihet në dukje qëndrimi se religioni personal është e vëtmja "e drejtë" "e vërteta", kurse të tjerat janë "të pa vërteta". Qëndrimi i këtillë forcon kufijtë religjionit dhe të konfesionit dhe çon drejt zhdukjes së lidhjeve natyrore me grupet e tjera religjioze dhe konfesiona-



le. Ajo mund tē përfundojë edhe konflikte mes tyre. Pra, a mundet që tē jetojnë bashkë ekskluzivizmi religjioz dhe pluralizmi religjioz/konfesional? Sigurisht që jo.

b) *Inkluzivizmi*: sociologjikisht vëhet në dukje ideja për një religjon tē vetëm botëror. I lënë pas dore dallimet mes tyre që janë në dobi tē bashkimit tē përgjithshëm.

c) *Pluralizmi*: Njerëzit ndjekin përkatësinë e tyre religjioze dhe konfesionale dhe kanë kuptim dhe konsideratë tē plotë ndaj ijtihareve dhe besimit tē tjetrit. Nga këtu lindin lëvizjet ekumene, përforcimet e dialogut etj. Të gjitha këto veprime janë ato që mund direkt ose indirekt tē kontribuojnë në forcimin e kulturës pluraliste religjioze tek banorët e këtij vendi. Sigurisht, kjo nuk përashton hulumtimin për forma dhe përbajtje tē reja, tē cilat do tē kontribuojnë në zvogëlimin e distancës religjioze dhe konfesionale, tē cilën lufata e ka lënë mes besimtarëve tē këtij vendi.

Jemi larg asaj që me tē dëshirojmë tē lëmë pas dore ngjashmëritë dhe dallimet mes religjioneve. Jemi tē vetëdijshëm për dallimet thelbësore sociologjike që dalin prej praktikës së adhurimit, vendit tē lindjes dhe kulturës së shpërndarë, doktrinës, mësimeve etike, marrëdhënieve me botën etj. Të marrim vetëm bashkëpunimin në liturgjitet gruopore ku ekzistojnë dallime tē mëdha.

Ose kontribuimin në flijim; në disa religjione kontribuohet duke fliuar kafshë; në disa tjera lule, fryte (pemë), erëra, ushqim etj. Disa religjione kërkojnë që gjatë lutjes, tē mbulohet koka, disa atë e ndalojnë.

Në disa lutet duke qëndruar në këmbë me duar tē ndërlidhura, në disa tē tjera duke qëndruar në këmbë me duar tē lëshuara, në tē tretat ulur dhe më këmbë kryqas etj. Por, edhe dallimet e tjera sociologjike tē theksuara, nuk i jepin askujt tē drejtën tē mos respektojë "tjetrin" dhe që religjionin dhe praktikën religjioze tē tij ta konsiderojë më pak tē vlefshme.

Me këtë arrijmë edhe te një element tjeter sociologjik tē rëndësishëm për bashkëjetësë: *toleranca*, *durueshmëria*. Ajo ka dominuar në Kinë, në Indi, në mbretërinë e romake, në shtetet islame etj. Voltaire në "Diskutimet mbi tolerancën". Toleranca asnjëherë nuk është bërë shkak për luftë qytetare, thotë Voltaire, kurse jotoranca e ka mbuluar tokën me kufoma dhe gjak.

Toleranca nuk është tē thuash "unë jam tolerant". Tolerancë është tē jesh tolerant ndaj tjetrit dhe asaj që është ndryshe (në etnitet, re-

ligjion, konfesion, mendim, qëndrim politik). Toleranca është pandehje e shoqërisë civile, e jo vetëm njëra prej vlerave tē saj.

Sociologët pajtohen se toleranca nuk ka kuptim nëse subjekti i saj nuk ka fuqi shoqërore (vetëm nëse jam i fuqishëm mundem tē jem tolerant-ndaj tē pafuqishmit). Është gabim që tolerancën ta mendosh si durim ndaj dikujt (për atë edhe atë nuk e quajmë durueshmëri), pasi duron gjithë atë që duhet. Vetëzotërimi dhe brenga për tjetrin qëndron në thelb të tolerancës. Toleranca është vlerë morale. Në shoqëritë heterogjene etnike dhe konfesionale çështja e tolerances etnike dhe konfesionale është me domethënien tē veçant. Të jesh tolerant ndaj kulturës, popujve dhe religjionit tē tjetrit, gradualisht fiton kuptimin e tē qenurit i qytetëruar, i tē qenurit i edukuar mirë, me sjellje tē mirë.

Me tē drejtë sociologët pa-



ralajmërojnë se mund të ekzistojë liri e vënies në dukje të religionit dhe të konfesionit të simpatizuesve të religjioneve dhe të konfessioneve të ndryshme, por nuk do edhe të thotë se në ato bashkësi ekziston toleranca shpirtërore. Toleranca kërkon që ne të përbahemi nga ndërhyrjet në aksionet dhe në mendimet e tjetrit, edhe kur ato neve nuk ka konvenojnë. Toleranca vëhet në dukje edhe në marrëdhëni tona ndaj atij që edhe nuk e duam.

Në të kundërtën e tolerances, jotolerancën në shoqëri mund ta nxisin edhe pretendimi që hyjnorja të bëhet pjesë përbërëse e jetës zyrtare shoqërore. Ajo atëherë çon në trazira, konflikte dhe në persekutime.

Sigurisht që, ekzistojnë



edhe kufij të tolerancës. Nuk mund të tolerojmë nacionalistë, fashistë, sjellje raciste, rrezikimin e lirisë së tjetrit. Madje, jotoleranca ka arsyetim vetëm ndaj atij që pengon ekzekutimin e tolerancës. Pasi, toleranca religjioze dhe barazia shtetërore janë bërë "të shenjtat" e kohës moderne.

Për bashkëjetesë është me rendësi edhe sjellja jonë ndaj tjetrit dhe asaj që është ndryshe. Sociologja e historisë na paralajmëron se nuk është asnjë farë risie që "tjetrin" ta paraqesim barbar, kurse vreten trim, humanist, të drejtë. Ajo, sidomos është e qart në konfliktet shoqërore, të cilat, mes tjerash, përbajnjë karakteristika etnike dhe konfisionale.

Pranimi i "tjetrit" është një obligim moral. Religionet e këtushme "të gjalla" kërkojnë që fqiut të duhet dhe të respektohet. Sot ajo do të thotë të shkosh një hap përpara-të bësh dialog me fqiun (nuk mendoj vetëm për ato që janë pranë derës tonë). Mendoj për ata që i quajmë "tjetri" dhe "të ndryshëm". Se si do të udhëhiqet me sukses dialogu interreligjioz, duhet sinqerisht të pranojmë se cilat janë pengesat për bindjen tradicionale për "tjetrin". Atë pjesë të traditës çdonjëri duhet ta hedh nga torba që e "bartë në shpinë".

Në shoqërinë pluraliste, bashkësite religjioze do të gjenin mjaft hapësirë ku mund të bëhet dialog: prej

ndihmës dhe aksioneve të përbashkëta në zgjidhjen e problemeve sociale në shoqëri, deri te çështja dhe e natyrës ekologjike, droga, paqja, rindërtimin e objekteve fetare të prishura.

Pjesëmarrësit në dialog duhet të kenë lirinë e vtpërku-fizimit (e jo "ne" të caktojmë se kush dhe çka janë "ata"). Kur bashkësia shoqërore në aspektin religjioz dhe konfisional është pluraliste, e cila njerëzit i bën me shikime të ndryshme religjioze, dialogu mund të ofrojë rrugë drejt një harmonie. Dialogu mund të jetë vetëm pasurim shpirtëror për ata që bashëveprojnë në të. Çdo pjesëmarrës në dialog, duhet të jetë i gatshëm jo vetëm të "mësojë" të tjerët, por të "mësojë" edhe veten. Në dialog nuk ka ndarje të roleve të "mësuesit" dhe të "nxënësit". Çdo njëri në të njëjtën kohë duhet të luajë rolin edhe të mësuesit edhe të nxënësit.

Vetëm se, për dialog i nevojshëm është *besimi* (të zëniti besë njëri tjetrin). Kurse besimi, përsëri është i domosdoshëm, që të arrihet deri te pajtimi. "Kur në shtet ka shumë arsyë për urrejtje, religjioni patjetër të ofrojë mënyra të shumta për pajtim", paralajmëron Montesquieu. Ajo çka duhet të jetë e përbashkët në udhëheqje të tri konfessioneve me simpatizues më të shumtë në numër (islamik, ortodoks dhe katolik), të cilat (ndoshta jo me fajin e tyre) kanë qenë "të futura" në luftë dhe në hum-

bjen e besimit, është që ato të ngriten kundër keqpërdorimit të religionit dhe të konfisionit nga qëllime nacionaliste dhe partiake. Janë të obligueshme të ngriten mbi atë lloj të primitivizmit nëse ia duan të mirën vetvetes.

Ashtu sikur shteti që urdhëron se ku duhet të vihen në dukje simbolet e saj, duhet që edhe bashkësítë religioze të bëjnë të njëjtën përvénien në dukje të simboleve të tyre. Kryesisht, vënia në dukje e simboleve religioze të cilitdo religion, nuk duhet të iritojë askënd. Por, nëse ajo, në qarqe mikrosociale me theksim multikonfesional, bëhet në mënyrë ashtu sikur që jemi dëshmitarë sot (vënia në dukje në mënyrë dominuese të somboleve vëtëm të një konfesioni), atëherë ajo provokon shqetësim. Ajo përjetohet si një ekskluzivizëm religioz, i cili nuk preferohet në marrëdhëniet mes shoqërive moderne.

Të kthehem i te marrëdhëni interreligioze dhe interkonfessionale në shoqëri. Në marrëdhëniet ndaj religionit tjetër, kryesisht, fjala është përmarrëdhëni e bashkësisë "shumicë" ndaj asaj që është "pakistan". Të ralla janë rrëthet sociale që janë të dekoruara me një multikonfesionalitet të theksuar. Me atë problem, gjegjësisht me marrëdhëni ndaj "pakistan", gati sa ballafaqohet çdo bashkësi religioze. Dhe çdo bashkësi religioze në fillimin e saj ka qenë "pakistan" dhe këtë karakteristikë të "pakistan" e mban në his-

torinë e saj, ndoshta në ndonjë hapësirë tjetër gjografike (ndonjëherë në vendin ku edhe ka lindur). Grupe e "pakistan" shpesh vendosen në mëhallat e posaçme, ashtu që më lehtë t'i mbrojnë vetitë e tyre.

Pasqyrë e përhapjes kulturore dhe religioze të çdo bashkësie religioze, është qëndrimi i saj ndaj tjetrit, bashkësive "pakistan". Ajo, gjithashtu, është edhe pasqyrë e gjendjes së marrëdhënieve ndërkonfesionale.

Pse përfaqësuesit e religionit "shumicë" duhet të angazhohen, si shprehje e tolerancës, kur është fjala për religionet "pakistan"? Për manifestimin e lirisë së religionit që i takojnë; përmarrëdhënie tolerante ndaj shkrimeve të shenja të tyre; përtë drejtën e mbrojtjes së kulturës religioze të tyre; përtë drejtën e mësimbesimit; përtë drejtën që simpatizuesit e saj të mund të organizojnë jetën familjare në përputhshmëri me religionin që i takojnë; përtë t'u mundësuar atyre zhvillim në veprimitarë botuese dhe informative, si dhe lidhje me shtëpitë informativë dhe botuese në "qendra", e jo të pengohen; përtë t'u mundësuar shkrim, distribuim të botimeve të tyre, përkthimin e literaturës së tyre nga gjuhë të tjera; për

krijimin e kushteve për bashkpunim dhe mospengim në komunikimin e religioneve "pakistan" me rrëthet e saj jashta shtetit; për krijimin e kushteve për ndërtimin e tempujve dhe shtëpive të lutjes (si dhe të drejtën e posedimit me anë të blerjes apo dhurimit etj.); përtë drejtën e veprimit dhe të themelimit të organizatave përgjegjëse humanitare dhe bamirëse; përtë drejtën e shkollimit të kuadrit në vend dhe jashtë; për respektimin e festimit të festave fetare; për respektimin e mënyrës së ushqimit të tyre etj.

Ishte ky, shkurtimisht, shikimi i një sociologu ndaj marrëdhënieve interreligioze. Sigurisht që është e mundur që të njëjtat të shikohen edhe nga ndonjë prizëm tjetër.

Sarajevë, shkurt 2000.
Përktheu: Dr. Qani Nesimi



Shfrytëzoje kohën për të mësuar fëmijë tënde

Edukoje fëmijën tënd që të jesh i lumbur edhe ti



Begati të shumta që mundë të na dhurojë është vetëm All-lahu i Madhëruar. Krijesa njeri duhet të jetë e vetëdijshme se këto mirësi janë në shërbimin e tij dhe aq të shumta janë sa që numërimi i tyre është i pamundur. Në shumë ajete të Kur'anit Fisnik, cekën mirësi të panumërtë që nga qelli, toka, nëntoka, lumenjtë e deri tek furnizimi i një insekti më të vogël. All-lahu i Madhëruar thotë; “*Dhe ai ju dha gjithë atë që e kërkuat (që kërkoi nevoja juaj) dhe, edhe në qoftë se përpigeni t'i numëroni të mirat e All-*

*llahut nuk do të mundë të arrini t'i përkufizoni (në numër)...”¹; “*Po edhe nëse përpileni t'i numëroni dhunitë (të mirat) e All-lahut, nuk do të mund të arrini t'i përcaktoni ato...*”². Të gjitha këto, ne si familje muslimane duhet t'i shfrytëzojmë sa më të mirë që të jetë dhe t'i këshillojmë fëmijët tanë që edhe ata të kenë të ditur këtë dhundi. Ai krijoi për ne pjesën më të nevojshme të jetës, e ajo është familja: “*All-lahu krijoi për ju bashkëshorte nga vetë lloji juaj, e prej bashkëshorteve tuaja - fëmijë e nipa dhe ju furnizoi me (ushqime) të mira*”³.*

Ne këtu e kemi qëllimin që t'i ftojmë njerëzit që disa mundësi të cilat i posedojmë, t'i shfrytëzojnë në këtë kohë shumë të rëndësi-shme. Paria islame e trojeve tona gjendet në një kohë mjaft kritike si në aspektin ekonomik, social, historik po ashtu edhe në atë shpirtëror e sidomos në atë moral. Për këtë shkak novitet që çdo ditë që e kalojmë ta shfrytëzojmë në edukimin e vetvetes, familjes e më pas edhe rrëthit, sepse mundësitë janë mjaft të mëdha edhe nëse nuk janë në nivele luksoze si të vendeve më të zhvilluara ekonomikisht se ne. Nëse ndalemi dhe anko hemi në atë e të mendojmë se ne jemi të varfër, nuk kemi në dispozicion gjëra që na nevojiten për studim e edukim, do të ishte humbje e mëdhe e kohës por edhe një zhgënjim

i vetvetes. Sot kur All-lahu e ka begatuar këtë trevë me bukurinë më të madhe natyrore, me familje të shëndosha, një pjesë e mesit tonë gjatë kësaj stine me diell, mundohen që këto ditë të bukura t'i kalojnë në pushime, relaksime të ndryshme apo edhe thjeshtë kotë e kalojnë kohen... Shtresa e nxë-nësve gati sa ka rënë nën nivelin e dobët, duke menduar se tani është fundi i mësimave dhe i braktisin ato në tërësi. Nga ana tjeter, prindërit e tyre nuk marrin ndonjë masë të nevojshme që t'i ndalojnë fëmijët e tyre nga kjo gjendje e mjerueshme.

Pasi që shumica e popullatës sonë i takojnë besimit fetarë islam, përvëç shkollimit të nevojshëm; fillestar, mesem etj. na nevojitet edhe mësim-besimi fetarë. Për fat të keq, mënyra e jetesës sonë e ka marrë një kahje pak sa të rrezikshme, kahje kjo e cila sot për sot është duke e pasuruar individin vetëm materialisht e asesi shpirtërisht. E kemi harruar që krijesa njerëzore ka nevojë që së pari të plotësoje shpirtin e tij, ta zbukuroje atë dhe të ece në një rrugë drejtë ndërtimit të jetës materiale. Shumë nga familjet tona, për fat të keq nuk janë duke e mbushur shpirtin e fëmijës së tyre me ndjenja ndaj Krijuesit, dashuri ndaj Tij, Pejgamberit a. s. e më pas dashuri ndaj vet atyre. Mundësitë tona që posedojmë janë vërtetë të mjaftueshme, sepse për të mësuar dhe për ta edukuar dikë nuk nevojitet të vizitohet qelli apo ndo-



1. Ibrahim, 14/34.
2. Nahl, 16/18.
3. Nahl, 16/72.

një kontinent tjetër. Në atë vend ku jetojmë, duhet që ardhmërinë tonë ta edukojmë në fryshtë e fesë së cilës i takojmë. Kemi në dispozicion shumë banka shkollore dhe literaturë e cila sadopak do të na mundësonë që të kalojmë në një nivel tjetër të diturisë, por assesi të mos qëndrojmë në këtë gjendje siç jemi tanë.

Me përfundimin e këtij viti shkollor, nuk përfundon mësimi e as leximi i librave apo diçka që na drejtton drejtë shkencës. Kjo pak sa është keqkuptuar në mesin tonë, sepse shumica e nxënnësve e kanë ketë ideologji, sa që edhe prindërit e tyre e kanë këtë çështje të fiksuar në kokat e tyre. Përkundrazi, fëmijët tanë duhet t'i drejtojmë nëpër kurse të ndryshme qofshin sociale, kulturore apo fetare. Është koha kur stinën e pranverës dhe verës ta e kalojmë duke mësuar fenë tonë islamë, nëpër lagje, tubime të ndryshme apo në xhami. Sepse nuk jemi më të varfët materialistë se sa As'habu's-Suffe – shokë të Pej-

gamberit të cilët kishin vendosur që të qëndrojnë pranë xhamisë së Pejgamberit a. s. vetëm për të mësuar e nuk u interesonte aspak pasuria materiale. Nuk jemi as më të varfër se vendet e Azisë dhe Afrikës, por kemi shumë e shumë mundësi që të ecim përpëra dhe drejtë një vendi që do nëna lartësojë njohuritë tona.

kjo është ndaluar në vende të caktuara, por për fat të keq shumica e fëmijëve tanë e kanë këtë ves. Prandaj nuk do të ishte e udhës që nëse prindi e ndalon atë kurse në anën tjetër e ka këtë ves në veten e tij.

- Mënyra e të ulurit pranë familjes; Vite më parë kur në familje ka qenë rregull që të kihet kujdes se si ulemi në prezencën e prindërvë tanë, si të veprojmë kurata na ofrojnë apo urdhërojnë diçka, sot kjo assesi nuk praktikohet, kundërshtohet prindi etj.

- Sjellja ndaj prindërvë – kryerja e porosive të tyre; Kjo është një dukuri që i ka tejkluar kornizat e duhura. Një sasi e vogël e fëmijëve me përpikëri e kryejnë porosinë e prindërit. Ajo që është më e keqja se ka humbur edhe sjellja e tyre ndaj prindërvë, andaj në shumë raste përgjigjet e fëmijëve janë mjafëtë brutale ndaj prindërvëve.

- Të gjenjyerit e prindërit se po shkon tek shoku – shoqja; Në realitet kështu është duke deklaruar fëmija, por vend shkuarja e tij nuk është shoku por loja e pa nevojshme apo diskoteka, internet caffë etj.

- Kërkimi i të hollave; Në mënyrë që të blejë një nevojë shkollorë, i ankohet prindërit se i nevojiten të holla, por për fat të keq ato të holla janë duke u harxhuar në vende tjera.

- Sot të gjithë rininë tonë e gjemë në kafene, klube të degjeneruara, internet cafe etj. dhe pos kësaj do të na dalin edhe punë tjera për t'i larë borxhet e tyre aty.

Po të i kthehem i dukurive të mira, athua në vend të këtyre çfarë do të kishin mundësi për të bërë ata, nëse nuk do të mungonte kujdesi i prindërit? Padyshim se ne nuk do ta gjenim fëmijën tonë në klube e kafene të ndryshme por ata do t'i gjenim në:

- Dhomën e mësimit që kemi

ndarë për ta, duke lexuar, shkruar dhe mësuar mësimet shkollore apo vullnetare.

- Çerdhen familjare, i cili së bashku me ta do të bashkëngjitej në të qeshur, ushqim, biseda apo edhe në shikimin e ndonjë dokumentari televiziv.

- Tek shokët që vërtetë janë shembull i shoqërisë, ku së bashku do të mësonin.

- Në rreshtat e xhamisë ku do të mësonte fenë e tij dhe me ketë do të ishte shumë më i kujdeshëm ndaj prindërve, do të shijonte nga afër vlerat e tija në të ardhmen.

- Në mesin e atyre që mësojnë e këndojnë librin e All-llahut, Kur'anin Fisnik.

- Në mesin e atyre që janë duke bërë kuize e gara të ndryshme shkollore.

- Do të ishte nga ata që çdo mbrëmje e mëngjes do të reciton te para prindërve qoftë një poezi qoftë disa ajete nga Kur'ani.



- Nga ata që pesë herë në dite do të gjendej afér burimit të ujtit për të marr abdest, e që për çdo kohë namazi do të lutej edhe për prindërit etj.

Atëherë ne duhet që të bëjmë një zgjedhje për jetën tonë dhe të fëmijëve. Nëse sadopak e ndiejmë vetën musliman, nuk duhet që të ngujohemi e të mos e dërgojmë fëmijën tonë në mekabet e xhamive gjatë kësaj stine të ngrohtë verore. Për një kohë shumë të shkurtër do ta fitonim fëmijën që të jetë i lidhur shpirtërisht me ne e jo vetëm fizikisht. Ndoshta brenda dy viteve apo edhe më shpejtë do të mësojmë se fëmiu ynë është bëre hafëz i Kur'anit e që shpërbilimet në ahiret janë aq të mëdha sa që nuk kemi mundësi të bëjmë ndonjë krahasim me elementet e kësaj bote. A nuk ke dëshirë ti prind që në ditën e kiametit All-lahu të të dhuroj ty një tash/kapele prej floririt në kokë për shkak se fëmija yt mësoi librin e shenjtë Kur'anin? A nuk je i kënaqur nga paralajmërimet e ajeteve dhe haditave që ai fëmijë i cili lexon Kur'an në shtëpi, zbret rahmeti/mëshira e All-lahu, nuk hyn djalli në atë shtëpi, ajo shtëpi do të mbrohet nga ushtria e All-llahut që për ne janë të pa dukshme. Mos ty ndoshta të nevojitet që ta e shikon me sy të ballit këtë ushtri për ta dërguar fëmijën në bankat e mektebeve që të mësoje Kur'anin? Nëse mendon kështu, po të udhëzojmë që të informohesh rrëth ekspeditës së Bedrit ku All-lahu u ndihmoi muslimanëve me mijëra e mijëra ushtarë të pa dukshëm të tij...

"Pastaj All-lahu zbriti qetësinë e vet në të dërguarin e Tij dhe në besimtarë, zbriti një ushtri që ju nuk e patë..."¹

Është rasti që të mos e kalojmë pa e shfrytëzuar sepse përndryshe do të kaloje koha dhe fëmija jonë nuk do të ketë dëshirë as që të shkoje në xhami e as në shkollë... ai gjithmonë do të kërkoje që

të gjendet në mesin e atyre që janë të ulur nëpër kafenetë degjeneruese, dhe në vende se ai të bëje lutje të hajrit për ty, ai çdo ditë e më tepër do të dërgoje mallkime ty dhe të tjerëve.

Ejani o vëllezër muslimanë që ta mësojmë fenë tonë, t'i edukojmë fëmijët tanë në këtë verë ku nuk do të kthehet më kurrë, ejani edhe ju prind që së bashku me ju të mësojmë jetën e lumtur e edhe librin e All-llahut, sepse shumica nga shokët e Pejambarit a. s. Kur'anin e mësan pas të dyzetave. Për këtë shkak edhe u illogaritën gjenerata e artë në rruzullin tokësorë, sepse e kërkuan xhennetin e përhershëm të All-llahut xh. sh. për këtë: *"All-lahu bleu prej besimtarëve shpirrat dhe pasurinë e tyre me xhennet..."* (Tevbe, 9/111).

All-lahu xh. sh. dashtë që çdo familje të shtoje kujdesin e tyre ndaj fëmijëve, ndaj sjelljeve të tyre, mësimeve dhe ideve të tyre. Po të vazhdoje popullata jonë me ketë sistem të jetës që sot ka, për një kohë shumë të shkurtër do të kërkoje ndihmë urgjente nga të tjerët, sepse do të fundoset në humnerën e këtyre problemeve. Atëherë do të na nevojitet që edhe nga arka familjare e edhe nga ajo shtetërore të harxhojmë për parandalimin e virtyteve të shëmtuarë, sëmundjeve ngjitetë, gripave të rrezikshëm për jetë etj.

Kjo ështëjeta dhe dita jonë e cila nuk ka kthim. Çdo pjesë e kohës e cila kalon pa përfituar dicka nga dukturitë e moralit të shendosh, ajo është kohë e vdekur dhe e mallkuar, sepse Allahu xh. sh. betohet në kohën duke thenë: "Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm."²

1. Tevbe, 9/26.

2. Asr, 103/1-3.

PRAPË TEKNOLOGJIA JAPONEZE E THA FJALËN E SAJ

Japonia, një ndër shtetet që prodhon teknologjinë më të përparuar në lidhje me sistemet e transportit me shina ka vendosur ta hedh në faqet e historisë përdorimin e telave elektrikë.

Kawasaki Heavy Industries që mundëson shërbimin teknologjik të mjeteve të transportit me shina nëpër të katër anët e qyteteve më të rëndësishme të botës që nga Tokio deri në Londër ka zhvilluar një teknologji të re që do ti jap fund përdorimit të telave elektrikë që ushqejnë me energji mjetet e transportit si trenat, tramvajët dhe metrotë.




Modeli Swimo e prodhuar nga Kawasaki e zvogëlon në masë të pabesueshme kohën e karikimit të sistemit të fuqisë që përdoret në modelet e fundit të tramvajëve. Bateritë e reja nikel-hidrogen mund të karikohen brenda 10 sekondash, që do të thotë 60 herë më shpejt se koha që u nevojitet baterive standarde të tramvajëve.

Eksperjtë theksojnë se në sajë të këtyre baterive të reja, tramvajët nuk do të kenë më nevojë për telat elektrikë nga të cilët marrin fuqinë, por do të karikohen menjëherë në sajë të njësive të fuqisë që do të gjenden në çdo stacion. Pra gjatë çdo ndalese nëpër stacione tramvajët edhe do të karikohen aty.

Kawasaki ka bërë të ditur se ka filluar testimet për prodhimin e kësaj teknologjie të re që brenda 5 vjetësh planifikon që ta ofrojnë për përdorime publike.

ENIGMA MADHËSHTORE E TRURIT TË NJERIUT: TRURI I NJERIUT ËSHTË I PROGRAMUAR NË ATË MËNYRË QË TË BESOJË NË ZOT!



Kështu shkruhet në revistën prestigjioze shkençore New Scientist. Sipas studimit të kryer nga ana e njërit prej universiteteve më prestigjioze në botë universiteti Yale, i botuar në revistën shkencore New Scientist, truri i njeriut është "i programuar" që të besojë në Zot ose Krijues.

Sipas këtij studimi të kryer mes foshnjeve dhe fëmijëve në natyrën e trurit të njeriut ekziston besimi në Zot ose në një Krijues Fuqiplotë, sepse truri njerëzor është programuar të punojë nëpërmjet pyetjeve Pse dhe Si.

Sipas studimit edhe fëmijët në moshat 6 dhe 7 vjecare që nuk kishin marrë asnjë edukim fetar më përpëra besojnë vetveti se çdo gjë në botë ka një shkak dhe kjo i bën të besojnë në forca të mbinatyshme ose e thënë ndryshe në ekzistencën e Zotit.

Objektet fetare muslimane të qytetit të Beratit në vitet 1845-1850 sipas një preventivi osman

Historia e objekteve arkitekturore në përgjithësi, çfarëdo periudhe që i takojnë ato, paraqet rëndësi për zbardhjen e historisë kulturore që është zhvilluar në trojet shqiptare. Objektet e të gjitha kulteve në përgjithësi, dhe ato islame në veçanti kanë qenë të pasura me burime dokumentare gjetja e të cilave në sajë të hulumtimeve, do të ketë shumë çfarë të shtojë si material historik përpunimit të informacionit historik. Medresetë kanë qenë qendra të kulturës ashtu sikur se edhe bibliotekat e pasura në të cilat, të paktën sipas asaj që njohim nga burime të tjera të tërthorta të atyre kohëve, ka ekzistuar një literaturë e pasur orientale. Aq sa orientale, mund të supozohet mjaf lehtë që ajo literaturë ka pasur edhe elementë të letërsisë dhe kulturës shqiptare, të cilën pelegrinët apo nëpunësit e lartë Osman nuk kanë ditur ta spikasin, gjë për të cilën nuk kanë edhe pse të paragjykojnë pasi nuk e kanë njojur gjuhën e atyre teksteve. Edhe teqetë, zavijetë dhe dergjahët e tarikateve të ndryshme kanë pasur biblioteka të pasura. Mjaftoheni këtu vetëm duke përmendur faktin që hulumtuesi i gjinisë së literaturës alhamiade shqiptare (e njojur si letërsia e bejtexhinjve), Osman Myderrizi, pjesën më të madhe të kësaj literature, e pati gjetur nëpër teqetë e ndryshme të Shqipërisë. Prandaj hulumtimi i objekteve të kultit ngërthen një rëndësi sa studimore dhe të pëershprirshme, po aq edhe me rëndësi kulturore dhe kombëtare.

Dosja në fjalë ruhet në Arkivin Osman (që varet nga kryeministria turke) në Stamboll, nën kodin EV. 12633. Ajo përbëhet nga 14 fletë (varak) tri prejtë cilave janë pa shënimë, pra bosh. Dosja është hartuar menjëherë pas reformave të Tanzimatit. Ajo mban të dhëna për vitet 1845-1850 dhe mendohet se është hartuar në këto vite. Dosje të tillë kemi hasur edhe për qytete dhe kaza të tjera të perandorisë dhe hartimi i tyre nga ana e këshillit drejtues të vilajeteve është njëkohësisht edhe një shprehje e mënyrës së re sipas së cilës do të zgjidheshin punët pas Tanzimatit, pra shprehje e politikës centralizuese që kërkon të zbatonin reformat e dekretit të Gjylhanes.

Pas Tanzimatit pushteti qendror do të kontrollonte të ardhurat që mblidheshin duke derdhur kështu të gjithë të ardhurat e mundshme në arkën e pera-

ndorisë, nga ku do të dilnin më pas edhe buxhetet që i nevojiteshin çdo vilajeti për të mbajtur në këmbë administratën e vet ushtarake dhe atë civile. Në këtë prizëm edhe administratorët dhe klerikët fetarë muslimanë kishin të drejtë të kërkonin ndihmë për meremetimin e objekteve fetare të dëmtuara, veçanërisht gjatë fatkeqsive natyrore siç ishin tërmetet, por pasi të kishin vërtetuar se të ardhurat e vakëfeve të atyre objekteve mjaftonin vetëm për të mbajtur personelin fetar të tyre dhe jo për të bërë meremetime, për të cilat kërkohej ndihma e buxhetit perandorak.

Në këtë arsyetim administrativ u hartua edhe dosja, që përbën temën e artikullit tonë. Nëpërmjet kësaj dosjeje mund të identifikohen objektet e kultit islam në qytetin e Beratit, ose siç quhej në terminologjinë urbanistike osmane, të kasabasë së Beratit, siç janë xhamitë, medresetë dhe teqetë. Aty jepen të dhëna për vakëfet që kishte çdo objekt fetar dhe për shpenzimet e personelit të tyre.

Në dosje nuk jepet ndonjë informacion në lidhje me datën e ndërtimit të këtyre objekteve, por përmenden në emër të bamiresit me fondet e të cilit janë ndërtuar ose përmenden në varësi të lagjes në të cilën ndodhen. Fakti që emrat e këtyre lagjeve, një pjesë e të cilave të ndëruara që në vitet e fundit të sundimit osman, përmenden në aktet e regjistrative të kadinjve të Beratit të paktën që në gjysmën e dytë të shekullit të XVII, na lejon të supozojmë se këto objekte janë ndërtuar të paktën që në shekullin e XVII, sepse ashtu sikur se njigate në të gjithë perandorinë osmane, edhe në qytetet shqiptare ndërtimi i objekteve të kultit ishte fillimi i një qyteti të ri (siç është rasti i Tiranës dhe xhamisë së Sylejman pashë Bargjinit) ose i lagjeve të reja brenda qyteti (siç është rasti me disa objekte që do ti trajtojmë më poshtë).

Xhamitë

Në dosje përmenden 11 xhami. Tre pre tyre përmenden sipas bamiresve që i ndërtuan ato. Ato janë xhamitë e Hysejn Pashës në lagjen Murat Çelebi, Xhamia e Omer pashës (ky duhet të jetë nga Vrionët), Xhamia e Sultan Bajezidit. Ndërsa 8 xhamitë e tjera përmenden sipas emrit të lagjes në të cilën ndodhe-

shin. Ato janë xhamitë në lagjet Deli Bega, Izgur Mehmed beg, Vakëf, Baba Kadi, Hafak, Debag (Lëkurëpunesit), xhamia e mahqemesë në lagjen Hysejn Ngjala dhe xhamia e plumbit në lagjen Izgur Ahmed beg.

Mesxhidet

Në arkitekturën islame-osmane mesxhidet njihen si objekte që kryenin funksionin e faltoreve ashtu sikur se xhamitë, por ndryshorin nga këto të fundit, sepse ishin ngritur me materiale ndërtimore më të varfëra, kishin sipërfaqe më të vogël dhe në to nuk falej xhumaja. Një aspekt tjeter arkitekturor që i mungonte mesxhideve qenë minaret prej guri. Në dosje përmenden 9 mesxhide. Ato janë përmendur sipas lagjes në të cilën gjendeshin dhe janë mesxhidet në lagjet Gorrinc (Gorrice), Lagjja e re (xhedid), Hysejn Ngjala, Lagjja e vjetër (atik), Sikoshi, Hevlek, Lagjja e poshtme (Alt), Murat Çelebi, Debag (Lëkurëpunesve).

Teqetë

Objektet e kulteve mistike teqetë, zavijetë dhe dergahet kanë qenë të përhapura në hapësirat shqiptare gjatë sundimit osman. Në dosje jepen emrat e 9 teqeve, emrat e shehlerëve nga të cilat kanë marrë emrat këto teqe dhe lagjet në të cilat ndodheshin ato. Por në dosje nuk cilësohen tarikatet të cilave u përkisnin ato. Ato janë teqeja e shejh Hysenit në lagjen Gorrinc (Gorrice), teqeja e shejh Abdullah efendiut në lagjen Velabisht, teqeja e shejh Ismailit në lagjen Deli Bega, teqeja e shejh Asim efendiut në lagjen e Izgur Ahmed begut, teqeja e shejh Ahmed efendiut në lagjen Baba Kadi, teqeja e shejh Mahmudit në lagjen e vjetër (atik), teqeja e shejh Ibrahim efendiut në lagjen Hysejn Ngjala, teqeja e shejh Omerit në lagjen Murad Çelebi, teqeja e shejh Junusit në lagjen Hafakan.

Medresetë

Medresetë kanë qenë vatra të rëndësishme për edukimin fetar-kulturor dhe kombëtar të klasës së klerit musliman dhe mbarë administratës osmane në përgjithësi pasi që të gjithë nepunësit civilë më përparrë edukoheshin në këto shkolla pastaj profilizoheshin në shkolla të tjera të sistemit arsimor të cilat gjendeshin në Stamboll. Në këtë dosje është regjistruar vetëm një shkollë filllore, mektep, ai në lagjen Hysen Ngjala, që ndodhej ngjitur me medresenë në këtë lagje, por duhet të ketë pasur edhe shumë mektepe të tjermanë atë kohë, pasi që edhe ato përbën bazën e edukimit klasik Osman.

Në dosjen në fjalë në pjesën rrithë të ardhurave dhe shpenzimeve të objekteve të kultit fetar Islam nuk përmenden medresetë, me përjashtim të medresesë së Omer pashë Vrijonit, por edhe në lidhje me të nuk përmenden ndonjë burim vakëfnor.

Medresetë përmenden në fletën e preventivit (ke-

shif) rrith buxhetit që vilajeti i kërkonte thesarit perandorak në lidhje me meremetimet e objekteve të dëmtuara. Në këtë fletë përmenden tre medrese që kanë ekzistuar në Berat. Gjithashtu aty përmendet sasia e fondit të parashikuar për meremetime dhe numrin e ambienteve (dhomave) që ato medrese kishin. Ato ishin medreseja në lagjen Murat Çelebi (me 12 dhoma), medreseja në lagjen Hysen Ngjala (me 15 dhoma), medreseja pranë xhamisë së Omer Pashë Vrijonit (me tre dhoma).

Gjithashtu në preventiv janë kërkuar edhe fonde për meremetime të urave në lagjet Gorrice dhe Velabisht.

Lista e objekteve islame nuk është e plotë. Në të janë përmendur objektet e kultit me vakëfet e tyre si dhe objektet të cilat janë gjykuar se kanë nevojë për meremetime. Nga burime të tjera ne mësojmë se në qytetin e Beratit duhet të kenë ekzistuar edhe objekte të tjera, të paktën në Velabisht, që për një kohë të gjatë përbënte një lagje periferike të qytetit të Beratit. Kështu në literaturën jo aq të gjërë shqiptare që trajton çështjet e arkitekturës islame në Shqipëri ne kemi të dhëna edhe për xhaminë e Ismail pashë Velabishtit, teqenë e sheh Hasanit, në bibliotekën e së cilës ruhej deri në vitet e luftës së parë botërore, edhe fermani i sulltan Mehmedit II i gdhendur në një pllakë bakri, me të cilin sulltani i njilte zejtari të Janinës dhe të Beratit të drejtën dhe lirinë e ushtrimit të zanateve të tyre.

Në një dokument që e kemi gjetur kohët e fundit në arkivin Osman të Stambollit bëhet fjalë edhe për një medrese tjeter në Velabisht, e ndërtuar me fondet e një gruaje bamirëse, Rabijes. Më poshtë po jepim të përkthyer edhe tekstin e këtij dokumenti në të cilin përmendet kjo medrese, myderizi i mëparshëm dhe ai që e zëvendëson atë:

"Shkaku i kërkësës së të përvuajturit në derën e shtetit është ky: e drejta për administrim (tevliyet) dhe mësimdhënie e medresës së ndërtuar më përpara dhe e mbajtur hapur nga pasuria e Rabijes, bijës së Ahmet begut, bamirëse e mirësive, i qofshin falur edhe gabimet më të vogëla, mbi një copë tokë nga pronat e saj në lagjen Velabisht që ndodhet në qytetin e Beratit, i takonte Bajram efendiut, me vdekjen e të cilit, ky post mbeti vakant, ndërsa detyra që mbulonte ai e pakryer, prandaj këto dy detyra me dëshminë unanime të dijetarëve, të devotshme dhe imamëve kërkohet t'i jepet Osman efendisë, banor i qytetit të Beratit, ekspert i shkencave fetare dhe i njohur me paraqitjen e rregullt për të dhënë mësimin siç duhet, dhe pas gjithë këtyre dëshmive edhe unë i ngrati duke menduar se e meriton këtë detyrë ju paraqes juve, këshillit fisnik ndriçonjës, këtë kërkësë dhe ilam. Të tjerat i takojnë zotërisë që është përgjegjës për këtë çështje. Viti 1180 hixhri (viti 1764) Kadiu i Beratit Dervish Hasani." (Arkivi Osman i Stambollit, Fondi: Cevdet Maarif, No. 493)

LEHTËSIMI I DHEMBJES SIPAS SUNNETIT TË PEJGAMBERIT S.A.V.S.

Një kohë të gjatë te myslimanët ekziston traditë që fëmisi së posalindur t'i vëjnë në gojë një copëz hurmajë të përtypur mirë. Myslimanët këtë e bëjnë në bazë të praktikës së Pejgamberit s.a.v.s. i cili sipas Kuranit është dërguar si mëshirë për mbarë njerëzimin.

Maqë kjo traditë është praktikë e Muhamedit s.a.v.s. padyshim në këtë ekziston urtësi e madhe. Por, përveç urtësisë dhe kënaqësisë në pasimin e sunnetit të Pejgamberit s.a.v.s. dhënia e "gjërave të embla" fëmiut të posalindur në mënyrë dramatike zvogëlon dhembjen dhe të rrahurat e zemrës së fëmiut.

Një hulumtim shkencor interesant që u publikua në "British Medical Journal", më 10 qershor 1995, tregoi se padyshim është e dobishme t'i jepet fëmisi së posalindur sheqer për të zvogëluar ndjenjën e procedurave të dhembshme, sikurse shpuarja e shputës gjatë marries së kampioneve të gjakut ose para synetisë.

Hulumtimi me titull "Efekti analgjetik i sakarozës tek të posalindurit" i kryer nga Nora Haouari, Christopher Eood, Gillian Griffiths dhe Malcolm Levene në repartin post-natal të spitalit në Leeds të Anglisë, hulumtim i kryer me 60 fëmijë të shëndoshë të moshës 1-6 ditë pas lindjes, duke marrë 2ml të këtyre tretjeve: 12.5% sakarozë, 25% sakarozë, 50% sakarozë dhe ujë të sterilizuar.



Grupi i parë prej 30 bebeve kanë marrë shurup shekeri para testit rutinor (marrije gjaku nga shputa që zakonisht është e dhembshme) për të zbuluar verdhëza.

Grupi tjeter i bebeve kanë marrë ujë të destiluar.

Dhënia e 2ml të tretjes 25% dhe 50% saharozë në gjuhë të fëmijëve të posalindur para shpuarjes në shputë, dukshëm ka zvogëluar kohën e qarjes në krahasim me bebet që kanë marrë vetëm ujë.

Gjithashtu të rrahurat e zemrës së tyre janë normalizuar më shpejtë. Tretja e shekerit ka pasur efekt më të fuqishëm dhe koha e qarjes është zvogëluar me rritjen e koncentrimit të sakarozës. Nga kjo mund të konkludohet që sakarza mund të jetë analgjetik i dobishëm dhe i sigurtë tek të posalindurit.



Blass dhe Hoffmeyer gjithashtu kanë treguar që dhënia e 12% të tretjes së sakrozës dukshëm ka zvogëluar kohën e qarjes tek të posalindurit gjatë marres së gjakut nga shputa dhe gjatë synetisë. Ky hulumtim është publikuar në revistën "Independent", më 1995, si edhe në "British Medical Journal".

Praktika e Pejgamberit s.a.v.s. është shënuar në përbledhjet e haditheve, por shumica gjendet në dy përbledhjet sahih të Buhariut dhe Muslimit: Ebu Budrah transmeton nga Ebu Musai i cili ka thënë: **"Më lindi fëmiu, e dërgova te Pejgamberi s.a.v.s. dhe ai i vuri emrin Ibrahim. Pejgamberi s.a.v.s. përtypi hurmanë dhe ferkoi gojën e fëmiut me këtë."** Ekzistojnë edhe transmetime tjera të njajshme.

Hurmaja përmban sasi të mëdha sheqeri (70-80%), gjithashtu përmban edhe fruktozë që ka vlerë kalorike të madhe, treten lehtë dhe janë të dobishme për trurin.

Hurmaja përmban 2.2% proteinë, vitaminë A, B₁, B₂ dhe PPF - i rëndësishëm te pelagra. Përmban gjithashtu minerale të nevojshme për organizmin si kalium, natrium, kalcium, hekur, mangan dhe bakër. Kalciumi përqindja e të cilës është e lartë, është i rëndësishëm në parandalimin e gjakderdhjes në rastet e lindjes ose synetisë.

Kemi vërejtur sipas sunnetit gjithashtu që agjërimin gjatë Ramazanit preferohet të prieshet me hurma. Vlera e madhe e hurmasë gjithashtu është përmendur në versetet e Kur'anit fisnik në kaptinën Merjem:

"E ti shkunde trupin e hurmës se do të bijnë ty hurma të freskëta. Ti pra, ha pi e qetësahu..." (Merjem, 25-26)


Kjo është recetë e Allahut, Krijuesit për Merjemen gjatë lindjes së Isait a.s. Kjo është recetë e cila lehtëson dhembjet e lindjes dhe parapengon gjakderdhjen e madhe.

Mesazhi i Kur'anit fisnik është i qartë për çdo kohë dhe vend:

"Ne do t'u bëjmë atyre të mundshme që t'i shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t'u bëhet e qartë se ai (Kur'an) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?" (Fussilet, 53)

BARACK OBAMA:

SHBA MBRON ME LIGJ TË DREJTËN E MBULESËS SË MUSLIMANËS DHE DËNOJNË ÇDOKËND QË KËRKON T'A PRIVOJË ATË NGA KJO E DREJTË



Vizita e presidentit Amerikan Barack Obama në Egjipt nga ku ai iu drejtua mbarë botës islame për të dhënë mesazhet e paqes dhe bashkëpunimit të ndërsjelltë ka dhe duhet të mbetet si një ndër fjalimet më miqësore që një president ka mundur dhe do të mund të bënte në lidhje me çështjet e botës islame dhe perëndimit.

Mes të tjerash Obama e vuri theksin në marrëdhëni e mira që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë pasur me botën islame që në krijimin e tyre, duke përmbledhur në pak fjalë edhe këto të vërteta historike. Shteti i parë që e njoju Amerikën ka qenë Maroku, ndërsa në marrëveshjen e Tripolit në vitin 1796 John Adams do të shkruante: "Shtetet e bashkuara të Amerikës nuk kanë asnje armiqësi kundër ligjeve, fesë ose vetë muslimanëve." Kur amerikani i parë musliman u zgjodh në Kongres ai u betua duke vënë dorën mbi Kuratin e shenjtë që kleriku i krishterë Thomas Xheferson ruante në bibliotekën e tij personale.

Megjithëse para votimeve shtypi oponent republikan u mundua ta theksonte dhe ritheksonte prejardhjen muslimane dhe emrin musliman që fshihej mbas gërmave latine të tij, gjë të cilën demokratët u munduan ta shmangnin shumë këtë herë që vetë presidenti Obama që tha se "një afrikano-amerikan me emrin Barack Hussein Obama u zgjodh presidenti i Amerikës."

Obama dha dhe shifrën zyrtate sen ë Amerikë jetojnë rreth 7 milionë muslimanë dhe se 1200 xhami ekzistonin brenda kufijve të shteteve të bashkuara të Amerikës.

Ajo që do dëshironim ta theksnim qe mesazhi i prerë dhe i qartë i Obamës në lidhje me shaminë e femrës muslimane, të vërteta që edhe prijes të komuniteteve muslimane në vende të caktuara muslimane nuk i shprehin kaq qartë. Meqë ministri i arsimit shaiptar para pak muajsh guxoi të mbrojë sulmet arbitrale të drejtuesve të disa shkollave ndaj mbulesës së femrës le të citojmë fjalët që presidenti i shteteve të bashkuara të Amerikës i tha aq prerë dhe qartë në mbrojtje të shamsë:

"Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbron me ligj të drejtën e grave dhe vajzave për të mbajtur hixhabin dhe i dënon ata që kërkojnë t'i privojnë ato nga kjo e drejtë."

"Ka shumë rëndësi që shtetet perëndimore të shmangin pretendimet e tyre që ti detyrojnë qytetarët e tyre muslimanë të praktikojnë fenë e tyre si u vjen për shtat perëndimoreve, duke u diktuar grave muslimane se si duhen veshur ato."